



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shërbimeve Publike - Ministarstvo Javnih Sluzbi - Ministry of Public Services
Departamenti i Teknologjisë Informativë/Departman Informativne Tehnologije/Department of Information Technology

STRATEGJIA E QEVERISJES ELEKTRONIKE
2009-2015

Prishtinë, tetor 2008

PËRMBAJTJA:

PËRMBAJTJA:	2
1. HYRJE	4
2. GJENDJA AKTUALE	6
2.1. Aspektet organizative	6
2.2. Sektori i rrjetave	7
2.3. Fusha e Harduerit dhe Softuerit	7
2.4. Interneti	8
2.5. Shërbimet elektronike	9
2.6. Siguria	9
2.7. Burimet njerëzore	10
2.8. Buxheti	10
2.9. Gjendja aktuale në kompanitë publike dhe private	11
3. VIZIONI	12
3.1. Shërbimet elektronike të së ardhmes	12
3.1.1. e-Portali shtetëror	13
3.1.2. Regjistrat elektronikë	14
3.1.3. e-Administrata	14
3.1.4. e-Kadastra	15
3.1.5. e-Statistika	15
3.1.6. e-Punësimi	16
3.1.7. e-Prokurimi	16
3.1.8. e-ID	17
3.1.9. e-Tatimi	18
3.1.10. e-Tregtia	18
3.1.11. e-Dogana	19
3.1.12. e-Shkolla	19
3.1.13. e-Biznesi	20
3.1.13. e-Shëndetësia	20
3.1.14. e-Arkiva	21
3.1.15. e-Dosjet	22
3.1.16. e-Bujqësia	22
3.1.17. e-Transaksionet	23
3.1.18. e-Biblioteka	23
3.1.19. e-Kultura	24
3.1.20. e-Policia	24
3.1.21. e-Zgjedhjet	25
3.1.22. GIS-i	25
3.1.23. m-Shërbimet	26
3.1.24. e-Qeverisja lokale	27

3.1.25. e-Fotografia	27
3.2. Infrastruktura	28
3.3. Rrjetat	28
3.4. Qendra e të Dhënave.....	29
3.4. Masivizimi i internetit dhe niveli i bandwidth-it	29
3.5. Hardueri dhe softueri	30
3.6. Burimet njerëzore	30
3.7. Ndikimet buxhetore	30
3.8. Përfitimet ekonomike dhe sociale.....	31
4. LEGJISLACIONI.....	32
4.1. Amandamenti i ligjeve dhe modifikimi i politikave dhe standardeve.....	33
4.2. Ligjet dhe politikat e reja.....	33
5. INTEROPERABILITETI.....	34
5.1. Përshkrimi i interoperabilitetit.....	34
5.2. Interoperabiliteti në institucionet qeveritare të Kosovës	34
5.3. Interoperabiliteti pan-Evropian.....	35
6. SFIDAT	36
6.1. Sfidat e së ardhmes	36
Shkurtesa-Domethënia.....	37

1. HYRJE

Qeverisja elektronike është ofrimi i shërbimeve të institucioneve qeveritare përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (si WAN, Internetit, rrjetit mobil) ndaj qytetarëve, bizneseve dhe kategorive të tjera. Me aplikimin e qeverisjes elektronike qytetarët dhe bizneset, por edhe vetë qeveria, do të kenë shërbime efektive dhe shumë të shpejta, qasje në shërbim nga çdo pikë dhe distancë, nxitje të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, mundësi të ngritjes së aftësive, shërbime të përhershme në çdo kohë, prezantim të të arriturave kombëtare, etj.

Republika e Kosovës duke qenë pjesëmarrëse aktive në proceset e zhvillimeve rajonale e evropiane, do të angazhohet që edhe në fushën e qeverisjes elektronike dhe TIK-ut të jetë pjesë me rendësi në rajon dhe Evropë. Si pjesëmarrëse në forumet ndërkombëtare, Kosova të gjitha obligimet e marra për zhvillimin e shoqërisë së informacionit do t'i realizojë dhe atë në bashkëpunim dhe partneritet të plotë me palët e interesuara.

Megjithatë, qeverisja elektronike nuk na duhet vetëm për integritet evropian dhe rajonal, por në veçanti na duhet për krijimin e një shtylle tejet të rëndësishme të zhvillimit ekonomik dhe përparimit të përgjithshëm të shoqërisë kosovare.

Qeverisja elektronike aplikohet kudo në vendet më të zhvilluara të botës, e posaçërisht në shumë vende të BE-së. Me funksionimin e qeverisjes elektronike në këto vende, qytetarët marrin shërbimet nga administrata publike në mënyrë elektronike përmes e-Portalit shtetëror në internet, nga çdo distancë, pa patur nevojë të presin para sporteleve të administratës.

Në bazë të normave ligjore në fuqi përgjegjësia e vendosjes së standardeve dhe shërbimeve të teknologjisë së informacionit që duhet përdorur nga institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës dhe koordinimit të sigurisë së shërbimeve të teknologjisë së informacionit në institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës është vendosur në kuadër të MSHP-së

Përgjegjësia e nxitjes së zhvillimit të teknologjisë së informacionit është përcaktuar në kuadër të MTPT-së, por nga ana tjetër ka edhe organe të tjera nëpër institucione qeveritare të cilat janë themeluar pa ndonjë bazë ligjore dhe merren me ofrimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

Gjatë periudhës së kaluar në institucionet e Republikës së Kosovës janë implementuar sisteme të ndryshme të menaxhimit të informatave, Qendra e Sistemit, disa projekte të GIS-it, baza të shumta të të dhënave, disa ueb-aplikacione dhe ueb faqe, rrjeti qeveritar i teknologjisë së informacionit, trajnime në lëmin e TI-së, etj.

Në të kaluarën ka ndodhur që institucionet e ndryshme nuk kanë respektuar udhëzimet administrative, politikat dhe standardet e miratuara, ka patur mungesa të komunikimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve dhe mosbuxhetim të projekteve prioritare. Diferenca e madhe në pagë krahasuar me sektorin privat ka sjellur largim të ekspertëve në fushën e TI-së nga sektori publik. Mos reflektimi ndaj këtyre dukurive paraqet rrezik permanent edhe në të ardhmen.

Për të përmbushur standardet në fushën e qeverisjes elektronike dhe TIK-ut është e domosdoshme që të gjitha organet që merren me TI në kuadër të institucioneve qeveritare, t'i harmonizojnë projektet e tyre, që nga planifikimi, organizimi, koordinimi, implementimi dhe mirëmbajtja.

Çdo institucion qeveritar duhet të ketë njësinë për TI, e cila do të jetë përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë, për realizimin e shërbimeve të përbashkëta dhe përkrahjen për TIK-un, si dhe duhet të veprojë në përputhje të plotë me normat ligjore të miratuara nga organet përgjegjëse.

Në periudhën pasuese, do të krijohet Qendra e të Dhënave të Kosovës, do të rriten kapacitetet e infrastrukturës së rrjetave komunikuese, hartimi i politikave për masivizimin e internetit, kompletimi i paketës ligjore për TIK-un dhe qeverisjen elektronike, shërbime të shumta elektronike, ngritja e sistemeve të reja dhe integrimi i sistemeve informative ekzistuese, interoperabiliteti, ngritja e kapaciteteve njerëzore, etj.

2. GJENDJA AKTUALE

2.1. Aspektet organizative

Në të gjitha institucionet qeveritare, rolin kryesor për vendosjen e standardeve dhe ofrimin e shërbimeve elektronike e ka Departamenti i Teknologjisë Informative në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike. DTI-ja udhëheq dhe koordinon procesin e freskimit dhe elaborimit të vazhdueshëm të strategjisë në nivel të qeverisë, që ka të bëjë me investimet në teknologjinë e informacionit, në përputhje me nevojat dhe kërkesat e institucioneve qendrore dhe lokale; zhvillon dhe vendos standarde për rregulloret në lidhje me harduerin, softuerin, komunikimet me të dhëna dhe me zë, sigurinë, bashkëveprimin e sistemeve të kompjuterizuara; siguron raporte mbi statusin, etapat, analizat, konceptet, studimet, udhëzimet, prezantimet, seminarët, mbledhjet punuese dhe konferencat mbi teknologjinë e informacionit dhe projekte të ndryshme tek audienca brenda dhe jashtë qeverisë; planifikon, dizajnon, integron, bart, freskon, menaxhon dhe mbështet sistemet dhe kërkesat e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë edhe e-Qeverisjen, Qendrën e të Dhënave të Kosovës, etj; ndërlikohet me institucionet homologe nga qeveritë e vendeve në rajon dhe më gjerë për krijimin e efekteve të sinergjisë; përmes përfaqësuesit të vet merr pjesë në takime kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ndjek ngjarjet e konferencave dhe të ekspozitave që kanë të bëjnë me e-qeverisjen dhe tema me rëndësi të teknologjisë së informacionit, me qëllim të krijimit të një mjedisi bashkëkohor komunikimi dhe bashkëpunimi; elaboron dhe menaxhon marrëveshje të leverdishme me kompani të teknologjisë së informacionit për shërbime, mirëmbajtje dhe furnizim me kohë të teknologjisë së informacionit; krijon, shpjegon dhe kontrollon parashikimet e shpenzimeve të teknologjisë së informacionit, planet e buxhetit dhe zbatimin e tyre.

Ka edhe institucione të tjera që kanë të formuara organe që merren me TI-në. Në Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit ekziston departamenti i Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informative, pastaj organe të TI-së kanë edhe MEF, ATK, AKK, ZKM, Kuvendi i Kosovës, KGJK, AKP, MD, Dogana, SHPK, etj.

Nën organizimin e Departamentit të TI-së së MSHP-së janë mbajtur disa takime koordinuese me të gjitha institucionet qeveritare, por përsëri koordinimi nuk ka qenë në nivelin e duhur. Komunitet e Kosovës nuk kanë respektuar politikën dhe standardet e TI-së të miratuara nga organet qendrore. Në takimet ndërinstitucionale për TI-në të organizuar nga DTI-ja ka marrë pjesë një numër simbolik i përfaqësuesve komunal. Projektet e realizuara rrallë herë janë koordinuar me Departamentin e Teknologjisë Informative.

2.2. Sektori i rrjetave

Shumica e institucioneve qeveritare janë të lidhura në rrjetin qeveritar përmes kabllit optik dhe rrjetit mikrovalor. Përmes kabllit optik janë të lidhura: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidenca, Kryeministria, MSHP, MAPL, MPB, MKRS, MBPZHR, MSH, MPMS, Qendra për Regjistrim të Automjeteve, Gjykata e Qarkut-Prishtinë, Rektorati i UP, KK i Prishtinë, Biblioteka Kombëtare, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Instituti i Historisë, Muzeu i Kosovës, Enti Statistikor i Kosovës, Arkivi i Kosovës, Agjencia Pyjore, ASHAK, OSHP, MASHT, MTPT, IKAP, etj. Ndërsa përmes rrjetit mikrovalor janë të lidhura këto institucione: MTI, MEM, MMPH, MK, MD, IPK, IGJK, AKPM, Reparti i Gjinekologjisë, etj.

Gjithashtu, sa i përket telefonisë në shumicën e institucioneve qeveritare përdoret sistemi telefonik CENTREX.

Shumë institucioneve kanë rrjetat e tyre fizike të pavarura nga rrjeti qeveritar. Integrimi i rrjetave të ndryshme në rrjetin qeveritar do të kursej në masë të madhe buxhetin e Kosovës.

Të gjitha komunat e Kosovës kanë të realizuar rrjetin e tyre LAN dhe Intranetin përmes donatorëve (UNDP, KFOS, etj.). Komunat duke shfrytëzuar këtë infrastrukturë kanë arritur të realizojnë edhe projekte të tjera. Kjo i mundëson komunave që në të ardhmen të realizojnë projekte në mënyrë të pavarur, çdo herë duke u koordinuar me DTI-në.

Gjendja aktuale e infrastrukturës ndërlidhëse në mes të kuvendeve komunale dhe qendrës nuk është e kënaqshme. DTI/MSHP ka të shtrirë rrjetin qeveritar më kapacitete të limituara në të gjitha komunat, në qendrat e alarmimit, qendrat e paraburgimit dhe në spitalet regjionale me maternitet. Rrjeti qeveritar nëpër komuna është i bazuar në rrjetin mikrovalor të UNMIK-ut (**155Mbps** në rajone) që së shpejti pritet të kalojë në pronësi të qeverisë. Kapaciteti në disa regjione është **50Mbps**, ndërsa nga regjionet deri te disa kuvende komunale kapaciteti i rrjetit është **2Mbps**, por ka kuvende komunale që në rrjetin qeveritar janë të lidhura me kapacitete minimale **640Kbps**.

2.3. Fusha e Harduerit dhe Softuerit

Institucionet e Republikës së Kosovës janë të obliguara të përdorin standardet e harduerit dhe softuerit në bazë të “Politikës për harduer dhe softuer” të hartuar nga DTI-MSHP. Synim i kësaj politike është të garantojë kompatibilitetin e harduerit dhe softuerit me qëllim të funksionimit të mirëfilltë të sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Mosrespektimi i politikës së lartcekur nga disa institucione ka si rrjedhojë krijimin e shumë sistemeve, gjë që ka shkaktuar pengesa të theksuara dhe shpenzime të panevojshme brenda institucioneve qeveritare. Hardueri që përdoret nga institucionet shtetërore, ka platforma të ndryshme, por shumica e tyre përfaqësojnë teknologjinë: HP, IBM, DELL, CISCO, etj.

Në administratën publike në Kosovë, përdoren sisteme operative, softuer aplikativ dhe sisteme të menaxhimit të informatave.

Të gjitha sistemet e lartpërmendura janë të bazuara në “Politiken për Harduer dhe Softuer” dhe “Udhëzimi administrativ për përdorimin e softuerëve të licencuar”.

Në bazë të këtyre standardeve, si softuer standard përdoren produktet e Microsoft-it: Microsoft Windows XP, Microsoft Office XP/2003, Microsoft Windows Server 2003, Microsoft SQL Server 2000/2005, Microsoft ISA Server, Visual studio.NET 2003/2005, MS Exchange Server 2003/2007, MS Share Point Server 2003, etj.

Softuer për mbrojtje nga viruset përdoret antivirusi SOPHOS.

Ka institucione qeveritare të cilat përdorin sisteme të tjera operative me sisteme aplikative përkatëse.

Platformat për bazat e të dhënave që përdoren në institucionet qeveritare janë kryesisht MS SQL Server, Oracle 9/10, MySQL, MS Access, etj.

Sistemet e menaxhimit të informatave që përdorin institucionet qeveritare janë: Sistemi i Menaxhimit të Dokumenteve (DMS), Votimi elektronik në kuvendin e Kosovës, BDMS, PIP, Softueri për tatimin mbi pronë (DTP), Free Balance, SIGTAS, Sistemi i menaxhimit të pagesave, Sistemi i menaxhimit të personelit, Sistemi i menaxhimit të inventarit (ITD), Sistemi për regjistrimin e automjeteve, Sistemi statistikor, IPRR, GeoMedia, webGIS, Sistemi për regjistrimin e bagëtisë, ASPAUK, Aplikacionet për regjistrimin e bizneseve, Aplikacioni për regjistrimin e lejes për vozitje, Aplikacioni për gjendjen rrugore, Sistemi informativ i shëndetësisë (HIS), Info gather-EMIS, Softueri për pensione, Softueri për invalidët e luftës, Softueri për ndihmë sociale, SIMP, KPIS, KVIS, AFIS, CREG, AFIS, PDL, TDKOS, baza e të dhënave për privatizim, TIMS, ALEPHTOO-aplikacion për bibliotekat.

Ashtu si institucionet qendrore të Republikës së Kosovës edhe ato të kuvendeve komunale janë të obliguara të përdorin standardet e harduerit dhe softuerit në bazë të “Politikës për harduer dhe softuer” të hartuar nga DTI/MSHP. Për sa i përket harduerit që përdoret nga institucionet komunale, ka platforma të ndryshme, por shumica e tyre përfaqësojnë teknologjinë: HP, IBM, DELL, CISCO, etj.

Gjithashtu sa i përket softuerit, kuvendet komunale ashtu si institucionet qendrore qeveritare kryesisht shfrytëzojnë platformën e Microsoft-it: Microsoft Windows XP, Microsoft Office XP/2003 Microsoft Windows Server 2000/2003, etj.

Për mbrojtjen nga viruset përdorin antivirusin Sophos, por ka edhe komuna që përdorin antivirusë të tjerë.

Komunat në Kosovë përdorin aplikacionin e softuerit përmes Intranetit të dedikuar për administratën e komunave në Kosovë “*Aplikacioni i zyrës pritëse*”. Ky aplikacion mundëson regjistrimin e kërkesave të qytetarëve, shkëmbimin e informacioneve në mes të departamenteve, sistemin e brendshëm të postës elektronike, etj. Ky aplikacion softuerik operon në platformën Windows përderisa për bazën e të dhënave përdoret MYSQL.

2.4. Interneti

Të gjitha institucionet qendrore kanë qasjen në internet të organizuar në mënyra të ndryshme. Pjesa më e madhe e këtyre institucioneve shfrytëzojnë internetin përmes Qendrës së Sistemit të teknologjisë së informacionit të menaxhuar nga DTI/MSHP. Qasja në internet e këtyre institucioneve është e realizuar sipas nevojave të tyre dhe në pajtim me udhëzimet administrative në fuqi. Disa institucione furnizohen përmes sistemeve të tjera të TI-së (SHPK, MEF, DOGANA, etj.) apo janë të lidhura drejtpërdrejt me ISP-të private. Interneti nga institucionet e Republikës së Kosovës shfrytëzohet për nevoja pune, hulumtim, zhvillim, avancim si dhe për komunikimin me sisteme tjera të teknologjisë së informacionit.

Intraneti në institucionet qendrore momentalisht nuk përdoret.

Gati të gjitha institucionet e pushtetit lokal përdorin internetin. Shumica e këtyre institucioneve lidhen në internet përmes Qendrës së Sistemit të teknologjisë së

informacionit të MSHP-së, përderisa të tjerat përmes sistemeve të ndryshme përkatëse ose drejtpërdrejt me ISP-të private.

Kuvendet komunale me financimin e UNDP-së dhe KFOS-it kanë arritur të fusin në përdorim Intranetin me qëllim të funksionalizimit të aplikacioneve të ndryshme softuerike.

2.5. Shërbimet elektronike

Për stafin e qeverisë përveç shërbimit të postës elektronike qeveritare, shërbimit për menaxhimin e fajllave, hostimin e uebfaqeve të institucioneve qeveritare dhe shfrytëzimit të internetit nuk është ofruar ndonjë shërbim tjetër bazë. Janë krijuar disa baza të të dhënave, të cilat i shërbejnë stafit të ministrive të veçanta si Sistemi i Pagesave, Sistemi i Buxhetit, Regjistri i Transaksioneve Kadastrale, Regjistri i Automjeteve dhe Patentave të Shoferëve, Votimi elektronik në Kuvendin e Kosovës, KosGIRO që mundëson pagesën e faturave të ndryshme përmes internetit, etj.

Për momentin në proces janë krijimi Sistemit unik për të gjitha zyrat e Gjendjes Civile, Sistemit për menaxhimin e Burimeve Njerëzore që do të jetë unik për të gjitha institucionet.

Nga ana tjetër ueb faqet e institucioneve qeveritare përveç anës informuese dhe shkarkimit të disa formularëve elektronik, nuk kanë luajtur ndonjë rol tjetër.

Shërbimet elektronike që komunat ofrojnë aktualisht janë modeste. Uebfaqet e komunave kryesisht ofrojnë informacione mbi komunën dhe shërbimet e saj. Disa nga shërbimet elektronike funksionale janë: Aplikacioni për zyrën pritëse, Softueri i gjendjes civile për ndërlidhjen e komunave me nivelin qendror, Free Balance, Pip SYSTEM, BDMS, Shërbime të ndryshme kadastrale, Sistemi i tatimit në pronë, etj.

2.6. Siguria

Çështja e sigurisë është primare për funksionimin e sistemeve të TI-së në përgjithësi dhe për qeverisje elektronike në veçanti.

Mbrojtja fizike e pajisjeve është e domosdoshme për të zvogëluar rrezikun e qasjes së paautorizuar në të dhëna dhe për mbrojtjen kundër humbjes apo dëmtimit.

Sistemi Informativ i qeverisë së Kosovës në masë të madhe është i realizuar në bazë të standardeve dhe rekomandimeve të Cisco-s dhe Microsoft-it.

Gjatë kësaj periudhe është respektuar standardi i ruajtjes së fshehtësisë, integritetit dhe disponueshmërisë së informatave. Për këto arsye janë përdorur programe të ndryshme operative dhe aplikative për mbrojtje nga sulmet e jashtme dhe virusët.

DTI-ja ka investuar për të siguruar rrjetin nga ndërhyrjet e jashtme duke ndërtuar disa shkallë sigurie dhe aplikuar “Intrusion Detection System” (IDS), por është i domosdoshëm forcimi i mëtejshëm i sigurisë si dhe instalimi i “Intrusion Prevention Systems” (IPS), ndërsa siguria në rrjetin e brendshëm kryesisht është mbështetur në antivirus me qasje të menaxhuar nga qendra e sistemit, prandaj lind nevoja e investimit për forcimin e sigurisë së brendshme me instalimin e sistemeve IDS dhe IPS.

Siguria në qeverisje elektronike do të rritet në përputhje me implementimin e politikave të sigurisë.

Institucionet e pushtetit lokal janë pjesë e rrjetit të qeverisë së Kosovës dhe pjesë e standardeve dhe rregulloreve të sigurisë. Në shumicën e këtyre institucioneve mungon siguria e duhur fizike e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe siguria e të dhënave. Implementimi i projekteve pa i respektuar standardet ka rezultuar në zvogëlimin e sigurisë së të dhënave, duke bërë bartjen e të dhënave në mënyrë fizike përmes pajisjeve memoruese (USB, CD, etj). Rritja e sigurisë së të dhënave përkatësisht rritja e sigurisë fizike duhet të bëhet përmes projekteve të centralizuara në përputhje me politikat në fuqi përkatësisht standardeve të DTI-së për siguri.

Siguria e rrjetit të komunave që janë të lidhura me rrjetin qeveritar është në shkallë më të lartë se ajo e atyre që s'janë në një rrjet me qeverinë. Aplikimi i antivirus-it nëpërmjet serverit menaxhues të tij, ka optimizuar dukshëm rrjetin kompjuterik.

2.7. Burimet njerëzore

Gjendja momentale e burimeve njerëzore të TIK-ut në institucionet qeveritare është e pakënaqshme. Në të kaluarën, stimulimi i ulët i stafit të TI-së në administratën publike ka patur si rrjedhojë largimin e vazhdueshëm të kuadrit me përvojë nga sektori publik në sektorin privat. Po ashtu ka munguar harmonizimi i kompensimit të stafit sipas punës dhe përgjegjësive në administratën publike. Nuk është bërë në masën e duhur ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve njerëzore në sektorin e TI-së në administratën publike. Ka munguar hartimi dhe aplikimi i politikave adekuate dhe afatgjata stimuluese për burimet njerëzore. Pajisja e vazhdueshme me përvoja nga vendet e tjera nuk ka qenë në nivelin e duhur. Ka munguar mbështetja dhe përkrahja e duhur e organeve vendimmarrëse. Janë organizuar pak seminare dhe trajnime për sensibilizim ndaj TI-së dhe qeverisjes elektronike etj.

Në komunat e Kosovës, një eventalisht dy punonjës janë të angazhuar në lëmin e TI-së, por në shumicën e rasteve ata kryejnë edhe punë të tjera brenda komunës apo thënë thjesht ka titullin e punës për një vend tjetër pune e jo TI. Ka pas periudha kur në shumë komuna nuk ka pas fare staf të teknologjisë së informacionit. Kjo ka shkaktuar probleme të theksuara si për komunat përkatëse e po ashtu edhe për menaxhimin e Sistemit të TI-së nga DTI-ja.

Në të ardhmen është më se e nevojshme që në çdo komunë të ketë sektor të TI-së, dhe në vazhdimësi të koordinohet puna në TIK me DTI-në.

2.8. Buxheti

Investimet në fushën e teknologjisë së informacionit nga buxheti i Kosovës në DTI/MSHP, nga viti 2001 deri në vitin 2007 janë rreth 9.000.000€, ndërsa për vitin 2008 janë planifikuar 5.920.244€.

Disa institucione kanë ndërtuar sisteme të veçanta të TI-së si MEF, Shërbimi Policor, Shërbimi Doganor, ATK, Këshilli Gjyqësor, etj. Shuma e përafërt e investuar në lëmin e TI-së në Këshillin Gjyqësor të Kosovës është rreth 3.000.000€, për ndërtimin e sistemit të TIK-ut në Shërbimin Doganor nga viti 2002 e deri më tani janë shpenzuar 4.767.764€, ndërsa në SHPK janë investuar rreth 10.000.000€.

Në bazë të planifikimeve buxhetore për vitin 2008, buxheti kryesisht është i përqendruar në DTI. Shumica e institucioneve tjera qendrore nuk kanë buxhet të ndarë nga buxheti i

Kosovës për projekte kapitale, por mbështetja e projekteve të TI-së për këto institucione në të shumtën e rasteve bëhet nga donatorë të ndryshëm.

Në komunat e vendit, por edhe në shumë institucione qendrore qeveritare, projektet kapitale në TI kryesisht i kanë realizuar donatorët. Donatorët që kanë kontribuar shumë në projektet e TI-së janë: USAID, UNDP, Banka Botërore, KFOS, DFID, AER-i, SIDA, GTZ, IOM-i, etj.

Buxheti komunal është ndarë për mirëmbajtje të ndryshme dhe për pajisje me vlera të vogla.

2.9. Gjendja aktuale në kompanitë publike dhe private

PTK është ofruar i licencuar i shërbimeve të internetit përmes shërbimeve si p.sh. XDSL, ADSL (Telekomi) dhe GPRS (Vala). PTK ka një rrjet të fuqishëm të intranetit të shpërndarë në tërë territorin e Kosovës duke shfrytëzuar infrastrukturën e Rrjetit Qendror. Realizimi i Unazës Optike të rrjetit kryesor të transmetimit të sinjalit si dhe ekzistenca edhe e sistemeve mikrovalore në të njëjtën kohë si komunikim i nivelit të tretë, e bën shumë të sigurtë këtë rrjet.

Në Kosovë në fushën e TIK-ut operojnë disa kompani private. Sektori privat e ka të shtrirë infrastrukturën e rrjetit telekomunikues përmes rrjetit mikrovalor, kabllit optik dhe atë koaksial.

Kohëve të fundit infrastruktura e rrjetit komunikues përmes kabllit optik është duke u zgjeruar me të madhe. Të gjitha qytetet regjionale janë të lidhura përmes kabllit optik dhe është duke u bërë zgjerimi në qytetet e tjera. Rrjeti mikrovalor mbulon pothuajse 90% të territorit të Kosovës.

Që nga fundi i vitit 1999 e tutje është rritur numri i përdoruesve të internetit në mënyrë shumë të shpejt dhe numri i ofruar i shërbimeve në sektorin e TI-së. Shërbimet e ofruara nga sektori privat janë telefonia celulare, telefonia fikse, sistemi kabllorik i Televizionit, interneti, VoIP, etj. Shërbimi më i përdorur nga banorët e Kosovës është interneti, përmes së cilit mundësohet bartja e të dhënave, zërit, fotografisë, video, etj. Duke llogaritur të gjithë operatorët që veprojnë në territorin e Kosovës, qasja në internet ka arritur 50% në zonat urbane, ndërkohë që në zonat rurale ka arritur mbi 10%. Përafërsisht përqindja e tërësishme e shfrytëzimit të internetit arrin mbi 30%.

3. VIZIONI

3.1 Shërbimet elektronike të së ardhmes

Për një zhvillim ekonomik sa më të shpejtë dhe sa më përmbajtësor të Republikës së Kosovës, padyshim se hyn edhe pjesa e krijimit dhe e realizimit të strategjisë me shërbime sa më të shumta elektronike për qytetarët dhe biznesin në Kosovë. Krijimi i këtij mjedisi të shërbimeve elektronike do t'i mundësojë qytetarit, biznesit, por edhe vetë qeverisë, rritje të standardit të jetës, përparim dhe zhvillim të shpejtë në të gjitha fushat.

Me krijimin e një Kosove elektronike (e-Kosova) do të jemi pjesë e denjë e një Evrope elektronike (e-Evropa). Realizimi i qeverisjes elektronike do t'i mundësojë të gjitha kategorive shërbimin qeveritar, të shpejtë, në çdo kohë dhe nga çdo largësi, për t'i realizuar kërkesat e tyre të përditshme. Qeverisja elektronike do ta modernizoj administratën dhe do të krijoj një menaxhim efikas dhe me përgjegjësi në të gjitha nivelet e administratës.

Shëndetësia përmes elektronikës është një synim tjetër, përmes së cilës do të krijohen ndërhyrje mjekësore edhe nga distanca. Pacientëve të Republikës së Kosovës do ti sigurohen kartela shëndetësore dhe do të krijohen regjistra të shumtë elektronikë shëndetësorë në mënyrë që të gjithë të kenë historikun elektronik shëndetësor. Përfundimisht do të krijohet një sistem elektronik shumë efektiv i menaxhimit të informatave në shëndetësi.

Synim tjetër do të jetë e-arsimi ose arsimi përmes elektronikës. Së pari, do të vendosen bazat për një shkollim përmes elektronikës në të gjitha nivelet e arsimit. Ka filluar kompjuterizimi i shkollave të Republikës së Kosovës dhe ky proces do të vazhdojë me këmbëngulje deri në realizimin e plotë të këtij synimi. Do të arrijmë krijimin e bibliotekave elektronike për të krijuar hapësira të reja shumë të efektshme për nxënien e dijës. Do të krijohet një sistem elektronik gjithëpërfshirës i menaxhimit të procesit të arsimit në përgjithësi. Me projektet për një arsimim përmes elektronikës, do të rrisim nivelin e arsimit në shkallën më të lartë të mundshme. Në shkollat dhe universitet e Kosovës lëmia e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit do ta ketë hapësirën e merituar, në mënyrë që të kemi kuadro të afta dhe të mjaftueshme për Kosovën elektronike dhe për qeverisjen elektronike.

Drejtësia dhe Siguria përmes elektronikës është një synim tjetër që do të merremi gjatë kësaj periudhe. Krijimi i sistemeve efikase të sigurisë dhe të drejtësisë, do të krijojnë një mjedis më të sigurtë dhe një menaxhim elektronik të proceseve të drejtësisë dhe sigurisë në Republikën e Kosovës. Sistemet elektronike të ngritura, do të mundësojnë menaxhim shumë më të efektshëm në pikat kufitare, do të krijojnë dogana efikase, menaxhim të rreziqeve natyrore etj.

Përmes shërbimeve të ndryshme elektronike dhe masivizimit të tyre përmes internetit, institucionet jo vetëm që do të jenë tek qytetari, por edhe qytetari i krijohet mundësia e

pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në procesin e qeverisjes së vendit. Kjo pjesëmarrje elektronike (e-pjesëmarrja) do ta bëjë qytetarin më aktiv në vendimet e rëndësishme, qofshin ato politike apo jo politike.

Krijimi i mundësisë që të votohet në mënyrë elektronike (e-votimi), do të krijojë një demokraci elektronike (e-demokracia) dhe me këtë rast Republika e Kosovës do të demokratizohet edhe më shumë. Në këtë mënyrë Kosova do të arrijë standardet evropiane të demokracisë.

Përmes e-bankave dhe e-biznesit do të krijohet një mjedis i favorshëm i zhvillimit të sistemeve bankare dhe transaksioneve të cilat janë të domosdoshme për ofrimin e shërbimeve elektronike. Me këtë do të krijohen edhe mundësitë për realizimin e tregtisë elektronike (e-tregtia).

3.1.1. e-Portali shtetëror

e-Portali është sporteli elektronik, nga ku çdo qytetar përmes internetit mund të marrë shërbimin elektronik nga qeveria, duke eliminuar distancën, rritur efikasitetin, rritur shpejtësinë dhe duke qenë në shërbim 24 orë në 7 ditë të javës. Përmes e-portalit mund të kryhen shërbime për nevoja të biznesit (G2B) dhe nevoja të qytetarëve (G2C). Ndërtimi i e-portaleve qeveritare bëhet në platforma të ndryshme teknologjike, ndërsa e-Portali shtetëror i Kosovës është i ndërtuar në platformën Microsoft. Zakonisht e-Portali shtetëror ka domenin e vet të mbështetur në kryedomenin shtetëror, por në rastin tonë deri sa të kemi fituar kryedomenin e Republikës së Kosovës nga organizatat ndërkombëtare, e-Portali shtetëror ka një domen të përkohshëm.

Duke shfrytëzuar e-Portalin, qytetari apo kompania për zgjedh shërbimin elektronik tepër të sigurtë, që ka nevojë të marrë nga qeveria. Në e-Portal vazhdimisht do të vendosim shërbime të reja elektronike, sapo qeveria këto shërbime t'i bëjë elektronike. Editimi i e-Portal-it bëhet nga një grup i posaçëm koordinues ndërministror i menaxhuar nga institucioni kryesor qeveritar për shërbimet elektronike. Në e-Portal do të vendosen regjistrat e institucioneve publike, sistemi i pagesave, sistemi i Regjistratit të popullsisë, sistemi i punësimit elektronik, sistemi i mbrojtur i mailbox-it për e-shërbim, regjistri i kompanive të kualifikuara për shërbimet e certifikatave, sistemi i menaxhimit të dokumenteve kryesore, bazat e të dhënave për ndodhitë e jetës, etj. e-Portali krijon një mjedis të favorshëm për zhvillim ekonomik. Do të krijohet mundësia e realizimit të nënportaleve elektronike për qytetarët, bizneset dhe administratën publike, përfshirë edhe atë të nivelit lokal. e-Portalet mund t'i krijojnë edhe komunat dhe minoritetet për shërbimet e tyre ndaj qytetarëve.

Për të marrë një shërbim të sigurtë përmes e-Portalit shtetëror, shfrytëzuesi duhet të jetë i pajisur me kartelë elektronike të identifikimit (e-ID), përmes së cilës ai identifikohet si në rastin e nënshkrimit elektronik, pagesave elektronike, etj.

3.1.2. Regjistrat elektronik

Gjatë periudhës në vazhdim, do të krijohen Regjistra të rëndësishëm elektronik me platforma të përparuara, siç janë ata për Gjendjen Civile, Regjistrin e Automjeteve, Regjistrin e të Dhënave Personale, Regjistrin e armëve me leje, Regjistri i pronave, Regjistri i popullsisë dhe Regjistra të tjerë. Mbi bazën e këtyre të dhënave të rëndësishme, pastaj do të krijohen shërbime elektronike të cilat do t'u shërbejnë qytetarëve për t'u pajisur me dokumentacionet që ata kërkojnë.

Krijimi i Qendrës së të dhënave të Kosovës, do të jetë një parakusht për shfrytëzimin Regjistrave të ndryshëm dhe për komunikimin e Sistemeve të ngritura nga të gjitha institucionet qeveritare.

Në bazë të Regjistrave të krijuar, do të krijohen edhe Sisteme të avancuara të menaxhimit të informatave në arsim, sisteme të avancuara të menaxhimit të informatave në punësim, të pensioneve, të pagave, pasurisë, shëndetësore, bujqësore, gjyqësisë, buxhetit, arkivore, pronave, taksave, gjeografike, etj.

Po ashtu duke shfrytëzuar Regjistrat e të dhënave personale, do të krijohen Sisteme të avancuara informacionit siç është Sistemi i menaxhimit të Gjendjes Civile, Sistemi i Menaxhimit të Informatave të Automjeteve, Sistemi i Menaxhimit të Dokumenteve, Sistemi i Menaxhimit të Licencave për Armët, Sistemin e Menaxhimit të Emergjencave dhe sisteme të tjera të rëndësishme.

Duke shfrytëzuar Regjistrat kadastral elektronik dhe harta të përpunuara nga këto të dhëna, do të krijohet sistemi i avancuar i menaxhimit të rrugëve në Republikën e Kosovës.

Të gjitha këto do të arrihen duke bërë integrimin e bazave të të dhënave dhe duke integruar sistemet e ndryshme të menaxhimit të informatave.

3.1.3. e-Administrata

Si prioritet në vazhdimësi i institucioneve qeveritare është edhe Reforma në Administratën Publike, e cila mundë të realizohet në tërësi vetëm nëse ne krijojmë shërbime cilësore në administratë përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe shërbimet që mundësojnë qeverisjen elektronike.

Do të jemi shumë të angazhuar që të ofrojmë hapësira të mjaftueshme për të gjitha prioritetet e institucioneve qeveritare lidhur me ngritjen e shërbimeve të tyre elektronike për qytetarët dhe biznesin në Kosovë. Me krijimin e Qendrës së të Dhënave të Kosovës, do të krijohen burime të nevojshme dhe të domosdoshme të informatave për t'ja ofruar ato përmes e-Portalit shtetëror qytetarit, biznesit, por edhe vetë institucioneve qeveritare. Me prioritet do të konsiderohet fuqizimi i Qendrës së Sistemit dhe rrjetit qeveritar, masivizimi dhe siguria e këtij rrjeti, përmes së cilit do të ofrohen qasje dhe kryerje të shërbimeve për të gjitha institucionet qeveritare, si në nivelin qendror e po ashtu edhe në atë lokal.

Realizimi dhe plotësimi i vazhdueshëm me shërbime elektronike i e-Portalit shtetëror është me rëndësi parësore për një administratë publike moderne. Të gjitha pengesat burokratike të administratës do të eliminohen me ofrimin e shërbimeve administrative përmes e-Portalit shtetëror apo e-nënportaleve. Pritjet para sporteleve të zyrave administrative, si në nivel qendror dhe atë lokal do të eliminohen. Me shërbimet përmes vijës së internetit, administrata ofron shërbimet e veta të drejtpërdrejta, transparente dhe efikase.

Paralelisht me prioritetet e mësipërme, për të patur një administratë efektive do të ketë përparësi edhe ngritja e nivelit të kapaciteteve të burimeve njerëzore në administratë në aspektin e teknologjisë së informacionit.

Në modernizimin e një administrate publike me e-qeverisje, kanë rol të madh edhe orientimet programore rajonale, evropiane dhe botërore për qeverisjen elektronike dhe TIK-un.

Prioritetet e theksuara në kuadër të e-administratës, do të ndikojnë në masë të madhe në reduktimin e shpenzimeve administrative, gjë që paralelisht me synimin e BE-së do të jetë synim edhe i Republikës së Kosovës.

3.1.4. e-Kadastra

Realizimi i e-Kadastra do të ofrojë shërbime dhe informata të rëndësishme, për pronat, kadastrën dhe për sistemet e ndryshme të informatave gjeografike.

Shërbimet kadastrale elektronike mundësojnë pamjen apo posedimin e ngastrave nga Regjistri i tokave. Përmes këtij shërbimi qytetari, kompania apo institucioni, mund të kyçet në cilëndo parcelë që posedon si pronë, duke u bazuar në numrin që kanë parcelat e tokave sipas numrit të tokës së regjistruar. Aty mund të shikojë me saktësi vendndodhjen e parcelës së tij, duke e analizuar atë nga të gjitha pozitat e mundshme.

I autorizuari publik i shërbimeve elektronike kadastrale, në bazë të numrit të regjistrimit dhe kodit të parcelave mund të bëjë kërkimet e dëshiruara, si për vendndodhje, madhësinë e parcelës, cilësinë e parcelës, pronësinë e saj, dhe shërbime të tjera në bazë të autorizimit dhe përgjegjësisë.

Të gjitha ndryshimet bëhen përmes sistemit të menaxhimit të informatave kadastrale, i ndërtuar mbi të dhëna të shumta që mundëson Regjistri Kadastral. Vetëm personat e autorizuar të institucionit publik përkatës mund të kenë qasje për editime sipas procedurave ligjore. Aspekti i sigurisë së shënimeve do të jetë i nivelit më të lartë.

Shfrytëzuesit përmes kartelave elektronike të identifikimi (e-ID), do të kenë mundësi të qasen në parcelat e tyre, për të marrë informacionin e dëshiruar apo për të realizuar shërbimin që dëshirojnë rreth parcelave kadastrale.

Shërbime të tilla integrohen në e-Portalin shtetëror, në mënyrë që shfrytëzuesit e shërbimeve të tilla të mund të shërbehen nga një sportel i vetëm me të gjitha shërbimet elektronike të mundshme.

3.1.5. e-Statistika

Pas regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, do të synohet krijimi Regjistrimit të Popullsisë, që do të shërbejë jo vetëm për statistika por edhe për shërbime të tjera elektronike. e-Statistika do të ofrojë informacione të rëndësishme demografike, ekonomike, sociale dhe mjedisore për qytetarin, biznesin dhe institucionet qeveritare. Duke shfrytëzuar të dhëna të ndryshme nga Regjistrat e ndryshëm që do të krijohen, si dhe nga baza të shumta të shënimeve përmes sistemeve dhe softuerëve për statistika, do të gjenerohen raporte të shumta, të cilat mund të merren nga e-Portali shtetëror apo ueb faqe të cilat do t'i krijojnë institucionet statistikore për qëllime informacioni. Gjenerimi i raporteve statistikore nga të punësuarit apo jo të punësuarit (e-Punësimi), Statistikat e ndryshme nga të dhënat e fituara nga Sistemi i menaxhimit të informatave në arsim (e-Arsimi), statistika të ndryshme të fituara nga të dhënat e ndryshme gjeografike (GIS), statistika të fituara nga fatkeqësitë në komunikacion (e-shëndetësia, GIS, e-drejtësia, e-policia, etj), statistikat të fituara nga sistemi i menaxhimit të informacionit në shëndetësi

(e-shëndetësia), statistika të fituara nga procesi i votimeve (e-Votimi), statistika energjetike, statistikat rrugore, statistika ushqimore (e-bujqësia), statistika tregtare (e-tregtia), statistika biznesore (e-biznesi), dhe shumë e shumë statistika të tjera elektronike, do të jetë një begati, ku shumë qytetarë, biznese apo institucione do të shërbehen shpejt, saktë dhe në mënyrë transparente.

Orientimi drejt integritit të sistemeve dhe ngritja e sistemeve të tjera, duke u bazuar në Qendrën e të Dhënave të Kosovës, do të jetë parakusht për krijimin e mundësive për përfitimin e statistikave elektronike. Statistikat elektronike mund të jenë me qasje të kufizuara dhe pa kufizim. Tek ato me qasje të kufizuara shfrytëzuesit mund t'i qasen me kartelë elektronike të identifikimit (e-ID).

Përmes statistikave të tilla elektronike institucionet e Republikës së Kosovës, do të krijojnë plane, prioritete dhe strategji zhvillimore për vendin. Të dhënat e tilla janë tepër të rëndësishme për të gjitha fushat e jetës së një shoqërie moderne.

3.1.6. e-Punësimi

Në vendin tonë, çështja e punësimit do të jetë temë nga më kryesorët për një periudhë të gjatë kohore. Prandaj informacionet rreth mundësisë së punësimit për qytetarët do të jenë parësore. Mundësimi i këtyre informatave në mënyrë elektronike përmes e-portalit shtetëror apo e-nënportaleve, është ndihmesë dhe informacion i rëndësishëm për të papunët. Kjo formë elektronike e gjetjes së punës apo punësimit (e-punësimi), përmban edhe informacione të tjera të rëndësishme edhe për ata që janë të punësuar por edhe për vetë institucionet publike apo private të interesuara në këtë proces.

Të dhënat e tilla shërbejnë edhe për nxjerrjen e raporteve të ndryshme statistikore. I tërë procesi që nga të dhënat për të punësuarit apo të papunësuarit, profesionet, përvojat, vend punësimit, aspektet sociale, të dhënat personale, të dhëna shëndetësore, asistencat sociale, përjashtimet nga puna, proceset gjyqësore rreth të përjashtuarve nga puna, dhe shumë të dhëna të tjera, e bëjnë këtë mundësi elektronike tepër të domosdoshme.

E-punësimi mundëson edhe kërkime të ndryshme nga institucionet publike për të kërkuar profesione që atyre u nevojiten më së tepërmi. Kështu krijohet mundësia edhe e përzgjedhjes në listën e atyre që janë të interesuar për punë. Në fakt përmes e-punësimit mundësohet që në mënyrë të digjitalizuar oferta dhe kërkesa për punë të jenë përherë në gërshetim me njëra-tjetrën. Kompletimi i të dhënave të tilla përmes sistemit të menaxhimit të papunëve, krijon pasqyrën e saktë të numrit të papunëve si dhe ndikon në ngritjen shkollore e profesionale të tyre.

Përmes e-punësimit, kërkuesi për punë përmes internetit, pra nga largësia, do të ketë mundësi që të analizojë të gjitha vendet e lira të punës, të marrë të dhëna për vendin punës, natyrën e punës, pagën e punës, kohëzgjatjen e punës, dhe kushtet e tjera të kontratës së mundshme dhe njëkohësisht përmes internetit mund edhe të aplikojë për një vend pune.

3.1.7. e-Prokurimi

Edhe pse në këtë drejtim është filluar diçka, synimet janë që kjo të realizohet në tërësinë e saj. e-Prokurimi nuk është vetëm publikimi i shpalljeve të rezultateve prokuruese, por është një pasqyrim i një procesi të përcaktuar ligjor të aspekteve të prokurimit. Përmes internetit mund të paraqiten regjistrat e të gjitha kërkesave, po ashtu përmes internetit mund të dërgohen të gjitha ofertat. Përmes sistemit të menaxhimit të të gjithë procesit të prokurimit, në mënyrë elektronike do të mundësohet ruajtja e vlerësimit teknik dhe financiar të ofertave. Kështu, paraqitja e këtij procesi në mënyrë transparente rrit

besueshmërinë dhe efikasitetin. Po ashtu përmes sistemit të menaxhimit të këtij procesi, në bazë të drejtave të përcaktuara me ligj, çdo palë mund të shohë procesin dhe të ankoet nga distanca përmes internetit. Realizimi i e-prokurimit do të mundësojë largimin e barrierave që janë paraqitur më parë, duke rritur besimin e të gjitha palëve të përfshira. Të gjitha qasjet do të jenë të lejuara për të gjithë të interesuarit sipas lejimit të qasjeve në baza ligjore, që në rastet e kufizimeve duhet të përdorin identifikimin elektronik (e-ID). Kategorizimi i qasjeve do të jetë për secilin veç e veç, duke përfshirë autoritetin kontraktues, kontraktorët, ofertuesit, palët që ankohen, autorizuesit e njësive buxhetore, auditorët dhe kategori të tjera të përcaktuara sipas ligjeve në fuqi. Siguria e informatave përmes e-prokurimit do të jetë maksimale. Si për çdo shërbim tjetër qasja në e-prokurim do të mundësohet edhe përmes e-Portalit shtetëror.

3.1.8. e-ID

Krijimi i identitetit elektronik të qytetarëve dhe subjekteve juridike, është një parakusht për zhvillimin dhe aplikimin e qeverisjes elektronike. Kartelat elektronike të identifikimit përmbajnë një çip brenda së cilit janë të vendosura të dhëna personale për identifikim (PKI). Në realitet realizimin e këtyre kartelave elektronike e mundëson baza ligjore për nënshkrimin elektronik dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo ndodhë si në rastet e zakonshme ku për tu identifikuar kërkohet nënshkrimi dhe të dhënat se kush jeni, vetëm se këtu kemi të bëjmë me të dhëna elektronike dhe nënshkrim elektronik përmes ID kartelës. Qytetari si edhe çdo institucion i Republikës së Kosovës me tu pajisur me kartelë elektronike të identifikimit, do të mund të marrë shërbimet elektronike të ofruara nga institucionet qeveritare, përmes e-Portalit shtetëror apo e-nënportaleve. Të gjitha shërbimet elektronike të cilat ofrohen nga institucionet qeveritare, por që kërkojnë identifikimin elektronik, mund të realizohen vetëm përmes kartelave elektronike të identifikimit (e-ID). Kjo do t'i mundësojë qasje në shërbime elektronike edhe diasporës të cilët mund të kyçen në procesin e zgjedhjeve në Kosovë nga distanca (e-votimi).

Lëshimin e këtyre kartelave elektronike dhe vlefshmërinë e tyre, do ta bëjnë organet qeveritare të krijuara nga Qeveria e Kosovës, të cilat do të bazohen në të drejtën e nënshkrimit elektronik dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Në periudhën pasuese, kartelat elektronike parashikohen të jenë të detyrueshme për të gjithë qytetarët varësisht prej moshës së përcaktuar. Këto organe bëjnë edhe menaxhimin e tërë këtij procesi duke ndërhyrë edhe në rastin e humbjeve apo problemeve të tjera të mundshme. Kjo do të favorizojë vendin tonë në rastin e integriteteve evropiane, sepse plotëson një standard të rëndësishëm të BE-së. Meqenëse mobiliteti është esenca e shërbimeve elektronike, do të krijohet mundësia e lëshimit edhe të kartelave elektronike mobile të identifikimit (m-ID) të cilat mund të përdoren si një SIM kartelë përmes së cilës qytetarët mund të realizojnë shërbimet elektronike.

3.1.9. e-Tatimi

Një resor tjetër tepër i rëndësishëm i shtetit të Kosovës është tatimi elektronik. Realizimi i këtij projekti do të ndikojë në masë të madhe në mbledhjen e të hyrave, transparencën e plotë të këtij procesi, gjenerimin e raporteve të rëndësishme për shtetin dhe shoqërinë kosovare, pasqyra të cilat do të shërbejnë për planifikime buxhetore. Së pari, në përputhje me ligjin do të krijohet sistemi i ri i menaxhimit të të gjitha taksave që aplikohen në Republikën e Kosovës. Me krijimin e këtyre të dhënave të integruara në Qendrën e të Dhënave të Kosovës, do të krijohet mundësia që të gjitha institucionet, qytetarët dhe bizneset të marrin shërbimin e tyre sipas të drejtave të përcaktuar me ligj. Ndoshta një nga proceset me të rëndësishme të kësaj fushe për shtetin është, kryerja e obligimeve nga largësia, respektivisht përmes e-Portalit shtetëror. Në këtë proces siguria është maksimale dhe identifikimet dhe autorizimet realizohen përmes kartelës elektronike të identifikimit (e-ID). Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave do të krijojë të dhëna tepër të rëndësishme të realizimit të taksave elektronike. Po ashtu përmes tatimit elektronik do të mundësohen edhe raporte të domosdoshme statistikore për nevoja institucionale, shoqërore dhe shkencore. Me realizimin e taksës elektronike do të hapet mundësia edhe e realizimit të shërbimeve tjera elektronike, kështu që buxheti i shtetit do të ketë përfitime të shumta. Tatimet doganore në mënyrë elektronike po ashtu do të inkorporohen në këtë proces (e-dogana).

Të gjitha reformat në fushën e tatimeve që mund të bëhen gjate çdo periudhe mund të integrohen në mënyrë të shpejtë në sistemin elektronik të tatimeve.

3.1.10. e-Tregtia

Tregtia elektronike ka të bëjë me tregtinë që realizohet në mënyrë elektronike duke përdorur internetin. Kjo është e ndërlidhur ngushtë me paraqitjen e produkteve të ndryshme përmes internetit (e-biznesi) por që duke përdorur identitetin elektronik mund të realizohen kontrata elektronike të përmasave të ndryshme. Kjo do të varet nga kushtet që realizohet një tregtim i produkteve të caktuara. Në rastin e një e-Prokurimi të suksesshëm, autoritetet e biznesit mund të realizojnë kontratat e tyre në formë elektronike, në bazë të të drejtave të përcaktuara me ligj. Rastet e bartjes së produkteve softuerike nga largësia në adresën e duhur tregon një tregtim elektronik, pra duke përdorur e-Portalin dhe përmes identifikimit të nevojshëm me marrjen e produktit të dëshiruar dhe njëkohësisht duke realizuar pagesën elektronike (e-transaksionin). Realizimi i kontratave klasike dhe kontratave elektronike (e-kontrata) realizohet përmes replikimeve të sistemeve elektronike duke përfshirë edhe rrjedhën elektronike në banka, respektivisht sistemin elektronik bankar (e-banka).

Tregtia elektronike zhduk barrierat ndërkufitare dhe duke respektuar marrëveshjet rajonale, evropiane dhe më gjerë mbi tregtinë (e-marrëveshjet apo e-memorandumet), zhvillon edhe më shumë tregjet dhe në këtë mënyrë shumë tregje krijojnë një treg gjigant elektronik. Kjo zhvillon shumë tregtinë e lirë duke rritur konkurrencën në treg dhe njëkohësisht krijon favore për investime të huaja në Republikën e Kosovës.

Përmes tregtisë elektronike shteti i Kosovës ofron tregun e vet tek tregu rajonal, evropian dhe ai botëror. Kjo është esenciale për zhvillimin e gjithëanshëm të Republikës së Kosovës në periudhën pasuese. Prandaj tregtia elektronike është një synim që duhet realizuar patjetër nga institucionet e Kosovës.

3.1.11. e-Dogana

Sistemi doganor sigurisht që do të ndryshojë dukshëm gjatë kësaj periudhe kohore dhe kjo jo vetëm për sa i përket qarkullimit të mallrave por edhe qarkullimit të njerëzve. Sistemet ekzistuese doganore do të avancohen në mënyrë që të krijohen baza të shënimeve për të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me doganat. Kompletimi i plotë i të dhënave digjitale nga doganat dhe për doganat, do të krijoj parakushtin për shërbime elektronike doganore (e-doganat). Të gjitha aspektet që nga hyrje daljet në të gjitha pikat kufitare, aplikimi i akcizave apo taksave të ndryshme, identifikimi i udhëtareve apo automjeteve, klasifikimi i mallrave, etj do të menaxhohen përmes një procesi elektronik shumë efikas. Meqenëse, siguria e një vendi është një nga shtyllat kryesore të shoqërisë kosovare (e-police, e-drejhtësia, e-dosjet), realizimi i doganave elektronike është një ndihmesë apo thënë shkurt një kusht për një siguri maksimale.

Aspektet e sigurisë kanë përmasa globale dhe në këtë kuadër janë edhe angazhimet e shtetit të Kosovës, i cili synon futjen në BE. Procesi i integritit të Kosovës në BE bart në vetvete shumë detyrime të cilat duhet të plotësohen, ku njëra ndër to është edhe modernizimi i sistemit doganor dhe pikave kufitare. Këtë modernizim e përcakton arritja e sistemeve elektronike doganore respektivisht kufitare (e-doganat).

3.1.12. e-Shkolla

e-edukimi është një fushë tjetër me rendësi për të ardhmen e vendit tonë. Të gjitha proceset e një arsimit modern të shoqërisë kosovare do ti kalojnë procesit elektronik të mësimi. Përmes këtij procesi do të krijohet një sistem gjithëpërfshirës i menaxhimit të informatave në arsim. Përveç kompjuterizimit të të gjitha shkollave, aplikimit të modeleve të reja teknologjike në sistemin e arsimit, krijimit të rrjetave të ndryshme akademike, futja e të gjitha niveleve të arsimit në një rrjet funksional, mësimi në distancë, përmes projektit e-Shkolla synohet të arrihet nivel më i lartë i komunikimit mësimdhënës – nxënës - prind. Nivel i tillë komunikimi do të shoqërohet me shpejtësi, saktësi, korrektësi dhe kyçje aktive të të gjitha palëve në procesin arsimor. Realizimi i këtij synimi do të mundësohet së pari me digjitalizimin e të dhënave të procesit arsimor në nivelin parashkollor, shkollor dhe universitar. Kjo mundëson gjenerimin e rezultateve periodike dhe dërgimin e tyre tek të gjitha palët e interesuara në procesin e shkollës elektronike. Po ashtu, do të mundësohet edhe mësimi në largësi si dhe marrja e të dhënave të nevojshme arsimore përmes internetit duke shfrytëzuar e-portalin shtetëror dhe e-nënportalet e tjera.

Arsimit si një nga shtyllat më të rëndësishme të shoqërisë kosovare, me implementimin e shkollës elektronike, do t'i jepet shtytja vendimtare për arritjen e standardeve të vendeve të zhvilluara në këtë fushë. Përveç tjerash, do të ketë mundësi të gjenerohen raporte të rëndësishme statistikore si për institucionet tona e ashtu edhe për institucionet ndërkombëtare të arsimit në Evropë dhe në botë.

Digjitalizimi i të dhënave të tilla dhe pasqyrimi i tyre përmes internetit do të krijojë një sistem modern të Arsimit në shtetin tonë dhe në këto informacione pastaj mund të bazohen edhe sisteme të tjera siç është rasti me e-punësimin, e-statistikat, e-bibliotekat, e-ID, e shëndetësia, dhe shumë shërbime të tjera elektronike.

Në të ardhmen pjesë e e-shkollës do të jenë edhe e-ditari, e-libreza, e-indeksi, e-certifikata, e-diploma, dhe dokumente të tjera elektronike me rendësi për arsimin në përgjithësi.

e-edukimi do të përfshijë edhe reforma metodike dhe programore në arsim ku ndër të tjera përfshirja e teknologjisë së informacionit dhe e përdorimit të saj do të jetë me prioritet në të gjitha nivelet shkollore.

3.1.13. e-Biznesi

Duke ditur rëndësinë e biznesit, është parësore që kësaj fushe përmes digjitalizimit të mjedisit biznesor t'i jepet vend i merituar, në mënyrë që zhvillimi i gjithanshëm i biznesit në Kosovë të ndodhë më të vërtetë. Përveç të dhënave të digjitalizuara mbi bizneset e regjistruara, përmes e-biznesit synohet të ndërtohet një Sistem i gjerë i informatave biznesore. Përmes këtij sistemi të avancuar, dukshëm do të lehtësohet hapja e bizneseve të reja, duke krijuar mundësinë e regjistrimit të bizneseve përmes internetit, pra nga largësia duke mos patur nevojë të vrapohet pas shumë procedurave burokratike të regjistrimit klasik. Po ashtu përmes këtij procesi elektronik do të mundësohet edhe licencimi i tyre duke reduktuar vështirësitë administrative të pa nevojshme.

e-biznesi do të krijojë një mjedis elektronik të produkteve apo informacioneve të tjera biznesore. Përmes biznesit elektronik, kompani të shumta do të paraqesin të arriturat e tyre. Reklamat e ndryshme, publikimet e ndryshme, shënimet e ndryshme mbi veprimtaritë biznesore, janë disa nga elementët e një biznesi elektronik.

Institucionet qeveritare përmes mënyrave të ndryshme stimuluese do të krijojnë mjedisin e nxitjes së biznesit. Përmes internetit të gjitha bizneset do të kenë qasje në ligje sandarde dhe rregulloret që mbështesin këtë kategori. Në mënyrë elektronike botës së biznesit do t'u afrohen orientimet programore qeveritare mbi zhvillimin e vendit. Përmes procesit elektronik do t'ju ofrohet çdo lehtësi investitorëve të huaj dhe atyre vendorë si dhe çdo informacion që nxit investimin. Procesi i licencimit do të bazohet në standardet e aplikuar në Kosovë. Të gjitha të dhënat e kompanive të mëdha dhe atyre të vogla sigurisht që janë një pasuri e madhe, dhe në bazë të të drejtave të përcaktuara qasja do të jetë në të shumtën e rasteve e hapur, por për raste të kufizuara do të përdoren kartelat elektronike (e-ID).

Kushtet e regjistrimit të një biznesi do të plotësohen përmes rrugës elektronike, e-kadastra për ngastrën se ku është ndërtuar ai biznes, e-transaksionet për pagesën e hapjes së biznesit, e-punësimi për regjistrimin e të punësuarve, etj. Shënimet e shumta elektronike biznesore shërbejnë edhe për nxjerrjen e raporteve statistikore që i duhen institucioneve të Kosovës, si: obligimet e bizneseve përmes elektronikës (e-taksat), raportet e kontributeve pensionale (e-pensionet), raportet për sigurime shëndetësore të kompanive (e-shëndetësia). Të dhëna biznesore do mund të gjenerohen edhe nga organizmat tjerë për nxitjen e biznesit si Oda Ekonomike e Kosovës apo të ngjashme. Aplikimi i e-biznesit mundëson kursime të shumta gjatë realizimit të bizneseve.

3.1.13. e-Shëndetësia

Krijimi i një sistemi modern të menaxhimit të informatave në shëndetësi është një objektiv me prioritet gjatë periudhës pasuese. Me realizimin e këtij sistemi elektronik shëndetësor do të krijohen baza dhe Regjistra elektronikë të të dhënave shëndetësore, siç është rasti me historikun elektornik shëndetësor (kartonët elektronik shëndetësor) për çdo qytetar, regjistri elektronik i sigurimeve shëndetësore, digjitalizimi i tërë procesit të lindjeve, krijimi i sistemit kompjuterik të menaxhimit të procesit farmaceutik, etj. Siguria e të gjitha këtyre shënimeve do të jetë më e lartë. Integrimi i shënimeve të tilla shëndetësore do të mundësojë edhe hulumtime shkencore. Në sistem do të integrohen të gjitha kodet shëndetësore të diagnozave.

Fushë tjetër e rëndësishme është edhe telemjekësia. Kjo do të mundësojë realizimin e proceseve mjekësore në distancë. Të gjitha proceset mjekësore, që nga mësimi, pjesëmarrja në hulumtime shkencore, operationet e drejtpërdrejta në salla, e bëjnë procesin e telemjekësisë jashtëzakonisht të leverdishëm dhe të domosdoshëm për t'u aplikuar në Kosovë.

Realizimi i shënimeve të rëndësishme dhe të shumta elektronike është edhe bazë e rëndësishme për raporte të rëndësishme statistikore, qofshin ato për nevoja brenda vendit dhe ato ndërkombëtare.

Për realizimin e projekteve të e-shëndetësisë patjetër duhet që institucionet të masivizojnë shfrytëzimin e internetit. Kapacitetet e rrjetave duhet të jenë të mëdha, sidomos të atyre që ndërlidhin institucionet shëndetësore të vendit. Fuqizimi i rrjetit qeveritar është prioritet i kësaj periudhe zhvillimore të projekteve të e-qeverisjes, prandaj kjo do të mundësojë gjithsesi edhe realizimin e e-mjekësisë edhe nëpër spitale, pastaj nëpër shtëpitë e shëndetit etj.

Realizimi i këtyre projekteve do të mundësojë një kontroll elektronik në shëndetësi, i cili është i shpejtë, i saktë dhe efikas.

Regjistri elektronik i vdekjeve do të jetë i rëndësishëm edhe për e-drejtësinë, e-policinë, e-statistikat dhe për regjistrat të tjerë.

Realizimi i projekteve që kanë të bëjnë me shëndetësinë elektronike mundësojnë që në mënyrë elektronike të ndërlidhen me sisteme shëndetësore rajonale, evropiane dhe botërore. Kjo mundëson ndërkommunikime të shpejta dhe ndërmarrjen e masave parandaluese në të gjitha fushat mjekësore në Kosovë.

3.1.14. e-Arkiva

Në aspektin e arkivimit të dokumenteve në Kosovë kemi probleme të theksuara edhe në aspektin klasik. Gjendja momentale tregon se shumica e institucioneve krijojnë arkiva për vetveten. Ky proces është shumë i vështirë dhe rrezikon me të madhe ruajtjen e të gjitha dokumenteve zyrtare të vendit.

Arkivimi elektronik i dokumenteve do të realizohet përmes dy proceseve paralele. Do të krijohet një sistem i menaxhimit të dokumenteve në mënyrë elektronike që njëkohësisht arkivon dokumentin dhe e menaxhon atë në etapa të ndryshme, por do të punohet edhe për arkivimin elektronik të të gjitha dokumenteve ekzistuese në arkivat klasike që ekzistojnë nëpër institucionet tona. Kjo tregon se procesi i digjitalizimit të plotë të arkivave të Kosovës do të jetë paksa i gjatë. Përderisa numri i dokumenteve të arkivuara në mënyrë elektronike do të rritet vazhdimisht, numri i dokumenteve të arkivuara në mënyrë klasike do të bjerë vazhdimisht.

Me krijimin e bazave të shënimeve për të gjitha dokumentacionet zyrtare dhe duke shfrytëzuar klasifikimin e dokumenteve sipas ligjit mbi publikimin e dokumenteve zyrtare dhe ligjit të arkivimit të dokumenteve, përmes sistemit të menaxhimit të arkivave dhe dokumenteve ato do të klasifikohen në mënyrë elektronike. Sipas të drejtave në qasje, qytetarët, biznesi, por edhe institucionet e Kosovës, përmes e-portalit do të kenë mundësi qasjeje, për të marrë dokumentin e kërkuar. Kjo do të rritë transparencën, do të krijojë hapësira të përherëshme dhe të shpejta për kërkime dhe analiza të ndryshme shkencore, do të krijojë burime të shumta elektronike për të gjitha fushat të cilat do të përfitojnë një shtytje të theksuar përpara. Prosesi i kërkimit të dokumentacionit të arkivuar elektronik është shumë i shpejtë dhe të gjitha institucionet, qofshin ato vendore apo ndërkombëtare në mënyrë elektronike në çdo kohë do të kenë dokumentin e nevojshëm. Mjafton qasja në internet dhe nepërmejt portalit shtetëror, çdo i interesuar në bazë të klasifikimit të dokumentit do të marrë shërbimin e kërkuar.

3.1.15. e-Dosjet

Të gjitha projektet që kanë të bëjnë me modernizimin e një drejtësie për ta bërë atë sa më efikase dhe të besueshme janë synim për periudhën e kësaj strategjie. Periudha e kaluar ka shënuar disa projekte në krijimin e një baze për një drejtësi elektronike mirëpo ato nuk mjaftojnë për të krijuar një sistem të vërtetë elektronik. Procesi i krijimit të dosjeve elektronike, do të mundësojë realizimin e një drejtësie elektronike. Procesi i dosjeve elektronike, do të përfshijë një proces nga policia elektronike (e-policia), procesin e gjatë apo të shkurtër nëpër gjykime, procesin elektronik të dënimeve të mundshme, procesin apo menaxhimin e informatave të të dënuarve në burgje apo shtëpi korrektuese, procesin e rikycjes në shoqëri pas vuajtjes së dënimit, etj. Të gjitha këto të dhëna janë tepër të rëndësishme për sistemin e drejtësisë, për sistemin e sigurisë së brendshme dhe atë ndërkombëtare. Në dosjet elektronike qasja do të jetë e veçantë për prokurorët, për gjykatësit, për mbrojtësit dhe me këtë hierarki kërkimet nëpër dosje janë të shpejta dhe me një siguri të lartë të dokumentacionit. Qasja e të gjitha kategorive do të sigurohet përmes identitetit elektronik (e-ID) duke ofruar siguri të plotë të tërë procesit gjyqësor. Përmes internetit qytetarët mund bëjnë padi duke shfrytëzuar identitetin e tyre elektronik. Realizimi i synimit për dosjet elektronike, do të ndihmojë edhe integrimin e sistemeve të tjera të cilat do të kenë ndikim shumë të madh në jetën e përditshme të vendit tonë. Kjo do të ndihmojë shumë në shkëmbimin e shpejtë të të dhënave në mënyrë elektronike, si në aspektin e identifikimit nga pikat kufitare e deri të identifikimi më i thjeshtë, si në aspektin e kompletimit të shpejtë të të dhënave në lëshimin e dokumenteve personale për qytetarët e vendit, shkeljet ligjore dhe keqpërdorimet e ndryshme, krimet elektronike, etj. Kjo do të ndikojë jashtëzakonisht shumë në reduktimin e shpenzimeve të shumta, të procedurave të shumta dhe të stërzgjatura ligjore në gjyqësi, do të ulë ndjeshëm numrin e të përfshirëve në krime të ndryshme dhe gjithashtu për raporte krahasuese statistikore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

3.1.16. e- Bujqësia

Republika e Kosovës ka burime të shumta bujqësore dhe pikërisht për zhvillimin e hovshëm të kësaj fushë do të ndikojë e-bujqësia. Për këtë qëllim si synim do të kemi krijimin e fermave elektronike (e-ferma), serat elektronike (e-serat), laboratorët elektronik bujqësorë. Krijimi i bazave të shënimeve për të gjitha kafshët, tokat bujqësore dhe cilësinë e tyre, fermat, serat bujqësore, bazave të shënimeve për drithërat, kullosat dhe pyjet, ujërat dhe peshqit, pemëtarisë, perimeve, etj është një synim madhor në këtë fushë. e-Bujqësia do të modernizojë dhe fuqizojë veterinarinë, nga se më digjitalizimin e shënimeve mbi kafshët dhe shëndetin e tyre do të krijohet edhe mundësia e krijimit të historive elektronike të shëndetit të të gjitha kafshëve që ka mundësi të kalojnë nëpër këtë proces. E njëjta gjë do të vlejë edhe për sëmundjet e bimëve, përfshirë këtu të gjitha perimet, pemët, gjallesat ujore etj. Me përparësi në këtë objekt do të jetë edhe krijimi i bazës së shënimeve lidhur me medikamentet e përdorura dhe atyre që duhen përdorur në fushën e bujqësisë. Kjo do të krijojë qasje të lehta në informacione të shumta të të interesuarve dhe do të ndihmojë shumë në zhvillimin e bujqësisë në përgjithësi në vend.

Kompletimi i Regjistrimit elektronik bujqësor të Kosovës do të mundësojë që përmes e-Portalit shtetëror, shërbimet në fushën e bujqësisë të merren shpejtë dhe lehtë. Po ashtu do

të krijohet edhe mundësia që shënimet të plotësohen duke përdorur identitetin elektronik (e-ID).

Nga ky regjistër do të dalin analiza të ndryshme si dhe raporte statistikore që do t'i shërbejnë bujqësisë kosovare dhe mekanizmave të ndryshëm vendor e ndërkombëtar që janë kompetent në këtë fushë. Përmes të dhënave të tilla të përpunuara, institucionet e vendit do të kenë mundësi të krijimit të politikave të avancuara zhvillimore në sektorin shumë të rëndësishëm të bujqësisë.

3.1.17. e-Transaksionet

Të gjitha shërbimet elektronike që ofrohen nga institucionet qeveritare, jo vetëm që janë shumë të rëndësishme, por ato kërkojnë edhe parakushte të realizimit të tyre. Në të shumtën e rasteve shërbimet elektronike realizohen përmes pagesave të caktuara elektronike e-transaksioneve. Përmes kartelave elektronike të identifikimit, shumë banka private kanë filluar të ofrojnë shërbimet e tyre bankare nga distanca. Kjo është një mundësi shumë e mirë dhe e shpejtë e realizimit të pagesave apo qarkullimit të parasë në menyrë elektronike nga vendi në vend, përkatësisht nga banka në bankë. Një synim i tillë duhet të realizohet edhe nga Banka Qendrore e Kosovës, e cila do të krijojë politika të tilla që nën mbështetjen e institucioneve qeveritare, të gjitha bankat që veprojnë në vendin tonë të krijojnë transaksione elektronike dhe kështu të kyçen në sistemin modern bankar të realizimit të pagesave dhe bartjes së parasë nga vendi në vend në mënyrë elektronike. Realizimi i një sistemi të tillë bankar elektronik (e-banka), do të mundësojë që qytetarët, bizneset dhe të gjitha institucionet të realizojnë shkëmbime bankare, pagesa elektronike, tatime elektronike, tregti elektronike, pagesa administrative elektronike, dhe në këtë mënyrë të marrin shërbimin elektronik përmes e-Portalit shtetëror që kanë ofruar institucionet qeveritare. Procesi i tillë do të krijojë domosdoshmërinë e krijimit të shumë kartelave elektronike bankare të identifikimit, por opsioni i realizimit të identitetit elektronik për çdo qytetar dhe institucion (e-ID) në Kosovë do t'i reduktojë këto. Me këtë rast identifikimi bëhet përmes sistemit të ngritur nga ana e institucioneve, i cili është shumë i sigurtë. Kjo nuk do të përjashtojë mundësinë që çdo bankë nëse ka dëshirë të vazhdojë të aplikojë procesin e sigurisë në aspektin elektronik e-banka. Megjithatë procesi kryesor identifikues dhe i mjaftueshëm për realizimin e një shërbimi elektronik përmes e-portalit shtetëror apo nënportaleve të institucioneve, do të jetë përmes kartelës elektronike të identifikimit (e-ID).

3.1.18. e-Biblioteka

Krijimi i bibliotekave elektronike është një synim që do ta realizojmë. Kjo do të jetë një shtyllë e rëndësishme e arsimit përmes elektronikës. Përveç kësaj, kjo do të mundësojë krijimin e rrjetave bibliotekare brenda vendit dhe jashtë vendit. Në bibliotekën kombëtare të Kosovës është realizuar një sistem elektronik i menaxhimit, por në periudhën pasuese institucionet qeveritare do të krijojnë hapësira dhe projekte konkrete që do të mundësojnë bibliotekën elektronike. Me këtë synohet që në sistemin bibliotekar elektronik të kyçen të gjitha bibliotekat që menaxhohen nga institucionet. Procesi i digjitalizimit të librit dhe dokumenteve të tjera në biblioteka, do të jetë një proces paksa i gjatë, por zgjerimi i bazës së Regjistrimit bibliotekar do të krijojë mundësi tepër të mëdha në avancimin e të mësuarit nga çdo palë e interesuar. Në këtë sistem do të kenë qasje, sipas të drejtave të përcaktuara, studentët, nxënësit, individët, institucionet arsimore, institucionet kulturore, institucionet shkencore, institucionet shëndetësore dhe shumë institucione të tjera. Me këtë proces do të

krijohet edhe mundësia e dhurimit të librit apo dokumenteve të caktuara nga ana e të interesuarave në mënyrë elektronike.

Realizimi i këtij synimi do të krijojë një mundësi të shkëlqyeshme të përdorimit të librit dhe dokumenteve të arkivuara (e-arkiva, e-kultura) jo vetëm për të interesuarit në Kosovë, por do të krijojë edhe mundësinë e kyçjes së institucioneve apo individëve të ndryshëm edhe nga bota.

Në përgjithësi do të krijohet mundësia që shkëmbimet bibliotekare të realizohen përmes regjistrave elektronikë ndërmjet bibliotekave të ndryshme elektronike ndërkombëtare. Me këtë, si në Regjistrin elektronik bibliotekar të Kosovës apo të ndonjë vendi tjetër, kërkimi dhe marrja e shërbimit realizohet në mënyrë shumë të shpejtë.

3.1.19. e-Kultura

Republika e Kosovës është e begatshme me kultura të ndryshme. Është pasuri e Kosovës numri i minoriteteve që jetojnë në të. Të gjitha këto kanë të arriturat e tyre kulturore. Monumentet e ndryshme historike, kulturore dhe fetare janë pasuri që duhet kultivuar por edhe bërë të njohur për të interesuarit brenda Kosovës dhe jashtë saj. Krijimi i Regjistrit kulturor është synim që pritet të realizohet. Së pari do të kompletohet baza e shënimeve për të gjitha monumentet kulturore me të gjitha karakteristikat e nevojshme, pastaj baza e shënimeve e të gjitha monumentet historike, baza e shënimeve e të gjitha objekteve fetare, baza e shënimeve e të arriturave arkeologjike, etj. Përveç njohurive që fitohen për pasuritë e shumta kulturore të Republikës së Kosovës, njohurive për të kaluarën e saj historike, me digjitalizimin e tyre dhe përmes publikimit të tyre në e-portalin shtetëror, do të marrë hov zhvillimi i turizmit në Kosovë (e-turizmi).

Gjithashtu kjo do të mundësojë një shkëmbim të shpejtë të të dhënave kulturore mes vendeve të ndryshme, gjë që do të ofrojë mundësi që të arriturat kulturore të jenë mundësi ofrimi mes njerëzve pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare.

3.1.20. e-Policia

Siguria e një vendi është parametër themelor për një standard të lartë jetësor. Orientimi në këtë fushë ka rëndësi të veçantë për zhvillimin e vendit, shtetit ligjor dhe demokracisë në Kosovë. Këtë vit është në proces realizimi i Sistemit të ri të menaxhimit të informatave rreth automjeteve dhe patentave të shoferëve. Krijimi dhe shfrytëzimi i Regjistrave siç është Regjistri i të gjitha automjeteve dhe patentave të shoferëve, krijon parakushtet e rëndësishme të menaxhimit të suksesshëm të sigurisë. Sistemet e tilla do të ndërveprojnë me Sistemin e menaxhimit të informatave në drejtësi (e-dosjet), Sistemin e menaxhimit të informatave të aksidenteve (e-shëndetësia), sistemet e menaxhimit në dogana dhe pika kufitare (e-doganat), sistemin e menaxhimit të rrjetit rrugor (GIS) dhe sisteme të tjera.

Puna e organeve të sigurisë do të lehtësohet jashtëzakonisht shumë, si dhe në masë të pakrahasueshme do të rritet efikasiteti i tyre në krijimin e një mjedisi të sigurtë për të gjithë qytetarët e vendit. Kjo do të ndihmojë edhe sigurinë jashtë vendit, sepse në mënyrë elektronike do të shkëmbehen të dhëna për dyshime dhe vërtetime të caktuara.

Patrullat policore do të jenë tepër efikase në punën e tyre. Ato përmes infrastrukturës elektronike përkatëse, do të kyçen nga largësia në shënimet që kërkojnë për të hulumtuar parregullsi të shfrytëzimit të automjeteve dhe patentë shoferëve, si dhe vendndodhjen e patrullave të tjera. Qasja e tyre do të jetë shumë e lehtë dhe e shpejtë, nga çdo vend ku ata patrullojnë. Me këtë do të rritet edhe besueshmëria dhe bashkëpunimi i qytetarëve të

vendit. Gjithashtu parregullsitë dhe keqpërdorimet e detyrave zyrtare nga ana e organeve të sigurisë do reduktohen maksimalisht.

Regjistri i automjeteve dhe patentë shoferëve do të ndihmojë dukshëm edhe në realizimin e projekteve të tjera të rëndësishme siç është rasti me parkimet elektronike (e-parkingjet apo m-parkingjet). Kjo do të përfshijë edhe komunat në këtë proces.

Po ashtu realizimi i pasaportave biometrike elektronike (e-pasaporta) do të lehtësojë identifikimin në pikat kufitare dhe me ndërveprimin e të dhënave të vendeve të tjera do të bëjë identifikimin në çdo vend që ndodhet individi i caktuar.

Menaxhimi i sigurisë do të jetë i përbashkët për të gjitha vendet e interesuara. Vendet e BE-së tashmë kanë përcaktuar standardet në këtë drejtim, kështu që realizimi i projekteve që kemi theksuar më lart, krijon lehtësirat e domosdoshme të hyrjes së vendit tonë në BE.

3.1.21. e-Zgjedhjet

e-Votimi do të jetë synimi ynë përmes së cilit do të realizojmë kabinetet elektronike (e-kabineti), pjesëmarrja elektronike në procese politike dhe jopolitike (e-pjesëmarrja), realizimi i debateve të drejtpërdrejta përmes elektronikës (video-konferencat), votimin elektronik të qytetarëve në zgjedhjet e caktuara në të dy nivelet (e-zgjedhjet), votimin elektronik në parlament dhe sistemin e menaxhimit të procesit parlamentar (e-parlamenti), etj.

Në këtë periudhë, duke bashkëpunuar me organet përkatëse të menaxhimit të zgjedhjeve që mbahen në vendin tonë, do të krijojmë së pari infrastrukturën mbështetëse për realizimin e votimeve përmes internetit, duke lëshuar së pari kartelat identifikuese elektronike (kjo mund të bëhet edhe me identifikim të brendshëm përmes një kodi të dërguar tek qytetari), realizimin e Sistemit të menaxhimit të procesit zgjedhor të dy nivelet, etj. Ky sistem do të mbështetet tek një siguri e plotë dhe në ruajtjen e vërtetë të votës së fshehtë. Gjatë kësaj periudhe në aspektin ligjor do të përcaktohet se cila votë ka vlefshmëri në rast të votimit të dytë gjatë ditës së votimit. Disa vende e kanë lënë përparësi, që vota vendimtare të jetë vota klasike në rast se votuesi ka votuar gjatë ditës edhe në mënyrë elektronike, ndërsa në disa vende të tjera përparësia është në votën e parë të bërë gjatë ditës së zgjedhjeve, pa marrë parasysh metodën e votimit.

Zgjedhjet elektronike do të mundësojnë një proces të shpejtë zgjedhor, transparent, dhe shumë të sigurt. Kjo formë e zgjedhjeve do të rrisë pjesëmarrjen e votueseve, të cilët për shkaqe të ndryshme hezitojnë të shkojnë tek kutia klasike e votimit për ta hedhur votën e tyre. Përparësi tjetër e këtyre zgjedhjeve është se ato krijojnë një rezultat shumë të shpejtë dhe përllogaritje pa keqpërdorime. Përfundimisht zgjedhjet elektronike (e-zgjedhjet) do të rrisin demokracinë e vendit tonë, por edhe në të gjitha vendet e botës që aplikojnë një sistem të tillë zgjedhor. Kjo formë e zgjedhjeve do t'ju krijojë mundësi diasporës e cila është shumë e madhe, të marrë pjesë në zgjedhje, sepse ata mund të votojnë nga largësia, dhe të kontribuojnë në zhvillimet e vendit përmes votës së dhënë në formë elektronike.

3.1.22. GIS-i

Sistemi i informatave gjeografike (GIS) është një sistem që aplikohet në shumë fusha të jetës për menaxhimin e informatave gjeografike. Prandaj zhvillimi i një GIS-i të unifikuar, me baza të shënimeve të integruara, do të jetë detyrë parësore e kësaj periudhe. Me krijimin e Qendrës së të Dhënave të Kosovës, do të krijohet baza e mirë e integritit të të gjitha shënimeve të digjitalizuara gjeografike të cilat janë krijuar deri më tash nga disa

institucione. Rreth integritit të shënimeve dhe krijimit të një GIS-i shtetëror, kanë filluar hapa konkret ku përmes një projekti konkret janë duke u krijuar të dhëna unike dhe Sistem unik i menaxhimit të informatave gjeografike.

Përmes Sistemit të ri integrues do të krijohen shtresa të reja të cilat do të shërbejnë për shkëmbimin e informatave të ndryshme, por edhe shërbimeve të ndryshme elektronike, të cilat qytetarët nga largësia përmes internetit do t'i marrin. Të gjitha shtresat e integruara, që nga të dhënat kadastrale, të dhënat mjedisore, të dhënat nëntokësore, të dhënat rrugore, të dhënat kufitare, të dhënat emergjente, adresat, vendbanimet, dhe shumë të dhëna të tjera, do ta bëjnë GIS-in tepër të rëndësishëm për të gjitha fushat e zhvillimit të vendit.

Aspektet e zhvillimit të shtresave të tjera do të jenë të hapura, duke krijuar kështu mjedis të favorshëm për avancimin e të dhënave gjeografike. Sa më shumë shtresa që të zhvillohet GIS-si shtetëror aq më shumë ka mundësi që përmes e-portalit shtetëror institucionet tona të kenë mundësi që të ofrojnë shërbime për të gjithë. Në këtë mënyrë, qytetari do të ketë mundësi qasjeje në mënyrë elektronike (e-ID) në parcelën e vet (e-kadastrari), institucionet në të dhëna mjedisore (e-ekologjia), institucionet dhe bizneset në të dhëna nëntokësore dhe mbitokësore energjetike (e-energjëtika), institucionet qytetarët dhe bizneset në analizat dhe projektet rrugore, qasje për institucione të cilat merren me emergjencat dhe katastrofat natyrore, etj.

Parakusht themelor për realizimin e GIS-it shtetëror të qëndrueshëm, është krijimi i hartave digjitale, në bazën e të cilit do të vendosen shtresat e tjera me informacione që i duhen të gjitha palëve si qytetarit, biznesit dhe institucioneve. Për një kohë të shkurtër në politikat qeveritare për harduer dhe softuer, do të futen standardet që i përkasin GIS-it ku të gjitha institucionet qeveritare do të jenë të obliguara që t'i respektojnë.

3.1.23. m-Shërbimet

Njëlloj si në rastin e shërbimeve elektronike përmes internetit edhe përmes telefonisë mobile mund të ofrohen dhe të shpërndahen shërbime elektronike, respektivisht m-shërbime. Të gjitha aspektet ligjore që mbështesin shërbimet elektronike përmes internetit (e-shërbimet) duhet të shikohen për të bërë të mundur që kjo të realizohet edhe për shërbimet elektronike mobile m-shërbimet. Në fakt ky është një synim që për një periudhë pak më afatgjate të realizohet. Kjo arrihet që përmes SIM kartelave telefonike të mundësohet krijimi i një identiteti elektronik (m-ID) që përmes qasjeve të tilla identifikuese të mund të realizohen shërbimet e ofruara nga institucionet qeveritare. Kjo mund të realizohet edhe në rastin e transferave elektronike bankare duke shfrytëzuar m-ID. Për marrjen e shërbimeve të ndryshme përmes internetit do të krijohet mundësia që shfrytëzuesi të përzgjedhë formën e shërbimit elektronik, për m-shërbimet apo e-shërbimet edhe pse në të vërtetë që të dyja shërbimet janë elektronike, por në rastin e shërbimeve mobile kemi të bëjmë me shfrytëzimin e tyre përmes identitetit të SIM kartelave (m-ID) nga pikat e ndryshme ku nuk ka nevojë të ketë kompjuter.

Në këtë drejtim duhet punuar shumë që aspekti i sigurisë të jetë maksimal, që në rastin e m-shërbimeve elektronike siguria të jetë e garantuar. Kjo varet shumë nga kompanitë të cilat ofrojnë shërbime mobile, se sa do të jenë të angazhuara në realizimin e parametrave maksimal të sigurisë së identitetit elektronik mobil.

Në vazhden e shfrytëzimit të telefonisë mobile, do të krijohet hapësira për realizimin e projekteve që kanë të bëjnë me parkingjet elektronike, ku përmes regjistrimit në baza të shënimeve, personi i caktuar mundet që të rezervojë një vend të caktuar në auto-park për automjetin e tij. Kjo do të ishte shumë e domosdoshme për qytetet ku vend parkingjet janë tepër të dëshirueshme. Përmes sistemit të menaxhimit të vendeve të parkingut, secilit shfrytëzues mund t'i bëhet me dije se a është parkuar në vendin e duhur apo gabimisht.

3.1.24. e-Qeverisja lokale

Për ofrimin e shërbimeve më afër qytetarit, janë shërbimet komunale nëse e shikojmë këtë nga aspekti klasik i dhënies së shërbimeve publike. Zhvillimi i hovshëm teknologjik dhe sidomos i fushës së teknologjisë informacionit, qasjen e tillë e ka ndryshuar plotësisht. Megjithatë të gjitha shërbimet elektronike ofrohen në baza të përgjegjësive të përcaktuara ligjore, andaj të gjitha komunat kanë një rol të theksuar në dhënien e shërbimeve elektronike ndaj qytetarëve, biznesit, por edhe ndaj vetvetes.

Në këtë drejtim institucionet e nivelit qendror do të krijojnë hapësira, qofshin ato të nivelit të infrastrukturës, qofshin ato të krijimit të hapësirave përmes politikave të miratuara, si dhe ndihmesa të tjera në aspektin e integritetit të sistemeve dhe bazave të shënimeve.

Në bashkëpunim dhe në koordinim të përhershëm do të realizohen projekte të rëndësishme për të gjitha komunat, përfshirë këtu avancimin e rrjetit dhe zgjerimin e tij, avancimin dhe shtimin e shërbimeve elektronike komunale, përfshirë edhe tatimin elektronik në prona (e-tatimi), krijimin e hapësirave të nevojshme në Qendrën e të Dhënave të Kosovës për nevojat komunale, pjesëmarrjen në krijimin e Sistemeve që menaxhojnë tërë procesin e një administrate komunale, aplikimet përmes internetit të qytetarëve të komunave për marrjen e një shërbimi, pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse komunale në mënyrë elektronike (e-pjesëmarrja), votimet elektronike komunale (e-zgjedhjet).

Gjithashtu shërbimet e ndryshme kadastrale elektronike janë të ndërlidhura me shërbimet e përditshme që bën komuna në këtë fushë (e-kadastru) dhe që shfrytëzon qasjen në e-portalin shtetëror për realizimin e këtij shërbimi, por që editimi i të dhënave kadastrale realizohet nga personi publik komunal sipas përgjegjësisë që ka me ligj. Pra këtu janë një varg hapash që do të realizohen në mënyrë të koordinuar ndërmjet të gjitha institucioneve pa marrur parasysh nivelet e pushteteve.

Dukshëm shërbimet komunale do të përcjellin efektin që rrjedh nga realizimi i e-shkollave, nga se në varësi të përpunimit të të dhënave që merren nga realizimi i një projekti të tillë, komuna në bazë të përgjegjësive që ka, duhet të ndërhyjë për të mënjanuar defektet e evidentuara në fushën e arsimit. E njëjta vlen edhe në shëndetësi, ku në bazë të statistikave të nxjerra organet komunale duhet të reflektojnë. Pra, kjo do të avancojë në masë të konsiderueshme përgjegjësinë e niveleve komunale.

Me shërbimet elektronike të qeverisjes lokale, qytetari vazhdimisht do të jetë i kyçur në procesin e realizimit të kërkesave të veta dhe transparenca e qeverisjes lokale do të rritet më tej.

3.1.25. e-Fotografia

Në botën e sotme fotografitë e ndryshme e kanë rëndësinë e tyre për përdorime në fusha të caktuara. Kjo fushë gjithnjë e më shumë po bëhet tërheqëse jo vetëm në aspektin individual por edhe në atë identifikues dhe hulumtues. Tashmë në krijimin e arkivave digjitale, bëjnë pjesë edhe fotografitë elektronike. Këto mund të jenë të skanuara ose të gatshme në formë elektronike. Krijimi i arkivave të fotografive elektronike do të lehtësonte shumë procesin e krijimit të identiteteve elektronike, por edhe në identitetet klasike siç është letërnjoftimi, pasaporta apo mjete të tjera identifikuese. Krijimi i arkivave elektronike me fotografi si përmbajtje do të lehtësonte procesin e shkëmbimit të të dhënave edhe në aspektin e sigurisë. Kjo do të mundësonte një identifikim të shpejtë si në pikat kufitare, por edhe në çdo vend kudo që është e nevojshme të bëhet një identifikim i njeriut. Po ashtu kjo ka edhe rëndësi afatgjate edhe për fushat e tjera të jetës. Do të ishte tepër e rëndësishme edhe për e-bujqësinë, e-kulturën, e-bibliotekën, e-shkollën, e-shëndetësinë, e-doganat, e-administratën, etj. Institucionet qeveritare do të krijojnë një

sistem të menaxhimit të fotografive, por siguria e të dhënave të tilla do të jetë e garantuar. Në të ardhmen qytetarit përmes kartelës elektronike të identifikimit (e-ID) do t'i mundësohet vendosja e fotografive të reja në bazat e shënimeve që kanë të bëjnë me fotografitë e caktuara, qofshin ato për njeriun, kafshët, natyrën dhe gjithçka tjetër që lidhet me jetën në tokë.

3.2. Infrastruktura

Infrastruktura e TI-së është parakushti kryesor për zhvillimin e qeverisjes elektronike. Ngritja e kapaciteteve të infrastrukturës bën të mundur ngritjen e kualitetit të shërbimeve publike përmes mënyrës elektronike. Kjo në masë të madhe do të lehtësojë, shpejtojë reformën e administratës publike, si zgjidhja më optimale përmes qeverisjes elektronike. Ngritja e infrastrukturës së TIK-ut përfshin këto elemente: qendrën e sistemit të teknologjisë së informacionit, qendrën e të dhënave, infrastrukturën e rrjetit komunikues (IRRK), ndërtimin e terminaleve, e-ID, etj.

Ngritja e kapacitetit dhe e krijimit të qendrës stabile të teknologjisë informacionit do të bëhet fillimisht përmes implementimit të qendrës së dytë, si qendër ndihmëse e qendrës ekzistuese dhe pastaj duke ngritur një qendër të re të rimëkëmbjes (disaster recovery center) në raste të katastrofave natyrore.

Ndërtimi i terminaleve do të bëhet në zyrat e qeverisë së Kosovës ose në pikat publike sa më afër lidhjeve të mundshme të IRRK-së për nevoja të qytetarëve, pagesa, aplikime, kërkime pune, etj.

Unifikimi i sistemeve të ndryshme të teknologjisë së informacionit brenda institucioneve qeveritare dhe shfrytëzimi i një infrastrukture të rrjetit komunikues, do të zvogëlojë në masë të madhe koston e shpenzimeve nga buxheti i Kosovës dhe është pjesë e strategjisë për një qeverisje më të mirë elektronike.

Institucionet kompetente për menaxhimin e pjesëve përkatëse të qendrave të informimit dhe infrastrukturës telekomunikuese duhet të harmonizojnë rregullat që përdorin, burimet financiare dhe modelet e biznesit për funksionalizimin sa më të mirë të qeverisjes elektronike.

3.3. Rrjetat

Gjatë periudhës në vazhdim të gjitha institucionet qeveritare do të jenë të kyçura në rrjetin qeveritar mikrovalor dhe në rrjetin qeveritar përmes fibrit optik. Aplikimi i këtyre rrjetave do të rrisë në masë të konsiderueshme kapacitetin nga disa Mbps deri në rangun e Gbps. Të dy rrjetet do të jenë alternativa të njëra-tjetrës duke mundësuar komunikim të vazhdueshëm ndërinstitucional.

Në institucionet qeveritare do të aplikojmë VoIP-në

Post-Telekomi i Republikës së Kosovës, ka synime për ngritjen e kapacitetit të rrjetit të telefonisë fikse, ngritjen e kapaciteteve të rrjetit të telefonisë mobile (3G) dhe përfundimin e kyçjes së të gjitha komunave të Kosovës në rrjetin optik.

Ne do të krijojmë hapësira të reja edhe për sistemet kabllorike koaksiale të cilat do të krijojnë qasje edhe në vendet më të thella rurale, për marrjen e shërbimeve elektronike.

Synim tjetër i institucioneve qeveritare është krijimi dhe menaxhimi i një mjedisi me brez të gjerë frekuencor në Republikën e Kosovës. Me vendosjen e standardeve dhe normave

ligjore për këtë mjedis brezgjere frekuencor, do të krijojmë mundësinë e shfrytëzimit të frekuencave të larta, për të futur në zbatim teknologji tepër të avancuara në këtë lëmi. Kjo do të ndikojë në mënyrë rrënjësore në masivizimin e shfrytëzimit të shërbimeve që ofron fusha e telekomunikimit, e më këtë edhe do të mundësohet shfrytëzim masiv dhe mobil të përdorimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike.

Qeveria e Kosovës do të krijojë hapësira të reja për operator të ndryshëm në fushën e telekomunikacionit, përfshirë këtu edhe teknologjitë: WiMAX, WiFi, etj.

3.4. Qendra e të Dhënave

Qendra e të dhënave do të jetë një depo kombëtare elektronike, për akumulimin, administrimin, përhapjen dhe ruajtjen e të dhënave. Qëllimi i qendrës është që të grumbullojë të gjitha të dhënat e nevojshme të Republikës së Kosovës, të lehtësojë interoperabilitetin e sistemeve të ndryshme, të rrisë efikasitetin e ofrimit të shërbimeve elektronike, të centralizojë aplikacionet dhe bazat e të dhënave, dhe të ofrojë siguri maksimale të të dhënave.

Qendra e të dhënave është njëri nga faktorët kryesorë në procesin e e-qeverisjes. Hardueri dhe softueri që mundëson funksionimin e qendrës së të dhënave, i përqendruar në një vend të vetëm, do të respektojë standardet dhe do të ulë dukshëm koston e shpenzimeve.

Qendra e të dhënave duhet të plotësojë standardet për lokacionin dhe infrastrukturën e ndërtesës, infrastrukturën elektrike, infrastrukturën e rrjetit, infrastrukturën harduerike, infrastrukturën e sigurisë, klimatizimin, mbrojtja nga zjarri dhe rimëkëmbja pas rrezikut.

Të gjithë Regjistrat elektronikë të institucioneve të Kosovës do të vendosen në Qendrën e të Dhënave.

3.4. Masivizimi i internetit dhe niveli i bandwidth-it

Interneti dhe masivizimi i tij janë faktor me rëndësi për vënien në zbatim të qeverisjes elektronike. Pa qasje në internet brezgjere (broadband) nuk mundësohet qasja e qytetarëve dhe e bizneseve në shërbimet e qeverisjes elektronike.

Numri i shfrytëzuesve të internetit është duke u rritur në të gjithë territorin e Kosovës. Zgjerimi i rrjetave në territorin e Kosovës do të rrisë shfrytëzimin e internetit në përgjithësi, ndërsa aplikimi i 3G dhe WiMAX do të ndikojë dukshëm në shfrytëzimin mobil të tij.

ISP-ja publike PTK, ka filluar të ofrojë shërbimin ADSL për qytetarët dhe pritet që vitin tjetër të kalojë numrin e 30.000 klientëve.

Duke marrë për bazë përqindjen e tashme në masivizimin e internetit, që arrin vlerën më shumë se 30%, gjatë periudhës së ardhshme synohet që kjo përqindje të arrijë në mbi 70%. Ky synim i parashtruar përfshinë të gjitha ISP-të publike dhe private ekzistuese si dhe ato që do të operojnë në të ardhmen, bazuar në politikat stimuluese që do të vendosë qeveria.

Do të krijojmë një mjedis ku shërbimet që ofron qeverisja elektronike, qytetari dhe biznesi i Republikës së Kosovës të ketë mundësi t'i shfrytëzojë ato nga pikat më të largëta të vendit tonë. Me realizimin e këtyre hapësirave shumë operatorë do të kenë mundësinë që të masivizojnë shërbimet e tyre përmes rrjetave të ndryshme, qofshin ato rrjeta fikse, rrjeta përmes kablove optike apo rrjeta përmes valëve.

3.5. Hardueri dhe softueri

Krahas zhvillimit teknologjik dhe masivizimit të e-qeverisjes duhet zhvilluar edhe politika për Harduer dhe Softuer, duke bërë amandamentime të nevojshme ligjore, duke investuar në teknologjinë me të re dhe me të avancuar të harduerit dhe softuerit.

Platformat ekzistuese do të perfeksionohen, do të zgjerohen, do të rriten kapacitetet harduerike dhe do të aplikohen platforma tjera të nevojshme të cilat do të mundësojnë realizimin me sukses të e-qeverisjes.

Softuerët do të kenë Arkitekturë të Orientuar drejt Shërbimeve (AOS) dhe Ueb Shërbimeve (të mbështetur në protokollet XML, SOAP, WSDL, WDDX dhe UDDI), Web 2.0, në mënyrë që të përkrahin kornizën e interoperabilitetit. Teknologjia që do të përdoret në të ardhmen do të jetë e koncentruar kryesisht në virtualizim.

Do të vazhdohet me sigurimin e licencave për softuer si dhe do të bëhen investime të nevojshme në zhvillimin dhe implementimin e aplikacioneve që mundësojnë realizimin e qeverisjes elektronike në tërësinë e saj.

3.6. Burimet njerëzore

Fuqizimi i institucioneve përfshin edhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe aftësive të tyre, stimulimin e vazhdueshëm të kësaj kategorie si dhe trajtimet e tjera duke respektuar standardet e BE-së në këtë fushë. Analiza e procesit të ngritjes së kapaciteteve në administratën publike është shumë e nevojshme që të kuptohet se çfarë mund të arrijnë institucionet tona në realitet. Është e kuptueshme se natyra e shpejtë e ndryshimit të teknologjisë do të paraqesë domosdoshmërinë e ndryshimeve, por edhe rreziqe për procesin.

Rritja e vazhdueshme e punëve dhe përgjegjësive në sektorin e TIK-ut në kuadër të institucioneve qeveritare të Kosovës detyrimisht implikon në rritjen e numrit të stafit në këtë fushë. Bazuar në synimet strategjike për projekte që do të realizohen gjatë viteve 2009-2015 obligohemi që të investojmë vazhdimisht në rritjen e kapaciteteve njerëzore. Kjo do të arrihet me mbështetje nga organet vendimmarrëse, përcjellje të vazhdueshme të të arriturave në botë në fushën e qeverisjes elektronike dhe TIK-ut, rekrutimin dhe mbajtjen e stafit të kualifikuar, trajnime të avancuara, forma të ndryshme stimuluese, respektim të prioriteteve dhe buxhetim të mjaftueshëm për projekte të planifikuara, koordinim ndërinstitucional, etj.

3.7. Ndikimet buxhetore

Realizimi i projekteve të planifikuara për periudhën që pason, kërkon buxhet të mjaftueshëm. Secili institucion për projektet e veta do të marrë buxhet nga totali i cili do planifikohet për realizimin e projektit të e-Qeverisjes. Hartimi i Planit të Veprimit për realizimin e projekteve që dalin nga kjo strategji do të pasqyrojë me saktësi tërë buxhetin që parashikohet të shpenzohet. Realizimi i projekteve të qeverisjes elektronike presim të bëhet edhe me financimin e donatorëve të mundshëm. Kjo bazohet në premtimet që janë bërë në konferencën ndërkombëtare të donatorëve për Kosovën. Me këtë do të zvogëlohen shpenzimet e buxhetit të Kosovës për implementimin e projekteve për qeverisje

elektronike dhe projektet që janë planifikuar kanë gjasa reale të realizohen në tërësi. Buxheti për qeverisje elektronike do të ndahet sipas nevojave dhe përgjegjësi të institucioneve në implementimin e projekteve.

3.8. Përfitimet ekonomike dhe sociale

Me realizimin e strategjisë për qeverisjen elektronike do të ketë përfitime të mëdha për shoqërinë kosovare. Përfitimet do të jenë ekonomike dhe sociale duke përfshirë modernizimin e administratës, arsimin, shëndetësisë, drejtësisë, sigurisë, zhvillimin e biznesit, zhvillimin e tregtisë, zhvillimin e bujqësisë, rritjen e buxhetit, rritjen e demokracisë, zhvillimin e kulturës, hulumtime shkencore, statistika të ndryshme, etj.

Disa nga përfitimet më të rëndësishme do të jenë:

- Krijimi i identitetit elektronik të qytetarëve
- Krijon një sportel elektronik ku merren shërbimet nga të gjitha palët duke përfshirë edhe njerëzit me të meta
- Zvogëlimi i ngarkesave dhe shpenzimeve administrative
- Do të rrisë transparencën dhe efektivitetin në administratën publike
- Krijon raporte efektive nxënës-mësues-mësues-prind në arsim
- Rritë dukshëm sigurinë dhe besueshmërinë në drejtësi
- Lufton dhe ul krimin e organizuar
- Digjitalizon të dhënat dhe automatizon përpunimin e informacioneve
- Zvogëlon kohën e nevojshme për marrjen e vendimeve
- Ul nivelin e korrupsionit
- Krijon hapësira për rritjen e investimeve
- Qytetarët dhe bizneset realizojnë detyrimet përmes internetit
- Realizimi i të hyrave në mënyrë elektronike monitorohet më mirë
- Lehtëson komunikimin me popullatën e sidomos me zonat rurale
- Me informacionet që publikon dhe trajnimet online që ndërmerr, ndikon në ngritjen e dijes dhe bën përmirësimin e teknologjisë në të gjitha fushat e jetës
- Për biznese do të ketë ulje të shpenzimeve
- Prezanton të arriturat kombëtare në botë
- Përgatitë vendin për integrimet evropiane, etj.

Ofrimi i shërbimeve në mënyrë elektronike do sjell kursime në buxhetin e Kosovës nga një anë dhe në anën tjetër do të sjellë përfitime në buxhet. Krijimi i regjistrave të bizneseve dhe mundësia e regjistrimit online të tyre si dhe mundësia e realizimit të pagesave elektronike, do të ndikojë në rritjen e të hyrave buxhetore.

4. LEGJISLACIONI

Si çdo fushë tjetër edhe fusha e qeverisjes elektronike dhe TIK-ut duhet të ketë mbështetjen ligjore. Gjatë periudhës së kaluar organet vendimmarrëse kanë miratuar disa ligje që kanë të bëjnë me këtë fushë, si Ligji për telekomunikacion 2002/7, Ligji për shërbimet e shoqërisë së informacionit Nr. 02/L -23, Ligji nr. 02/L-28 për procedurën administrative, Ligji 02/l-80 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/7, për lëndën arkivore dhe arkivat, Ligji nr. 2003/12 për qasje në dokumente zyrtare, Ligji për kadastër, etj.

Ligji nr. 2002/7 për telekomunikacionin qeveris të gjitha shërbimet e telekomunikacionit dhe të gjithë ofruesit e shërbimeve të telekomunikacionit në Kosovë dhe do të krijojë një mjedis ligjor, rregullator dhe transparent, i cili do të promovojë investimet dhe konkurrencën e lirë, për t'i përmbushur nevojat e të gjithë shfrytëzuesve për shërbime të telekomunikacionit.

Një ligj tjetër në fushën e e-Qeverisjes është Ligji nr. 02/L-23 për shërbimet e shoqërisë së informacionit, i cili është bazuar në ligjin model, të hartuar nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Ligjin e tregtisë ndërkombëtare-UNCITRAL. Me këtë ligj dokumentacioni në formë elektronike barazohet juridikisht me dokumentacionin tradicional, të paraqitur në format të letrës, për të lehtësuar veprimtaritë komerciale që përfshijnë, por që nuk kufizohen në shitblerje që bëjnë konsumatorët nëpërmjet internetit (e-Tregtia), shërbimet elektronike bankare dhe ato financiare (e-Pagesa), ofrimin e shërbimeve qeveritare (e-Qeveria), blerjen në formë elektronike nga ndërmarrjet (e-Prokurimi).

Ligji nr. 2003/12 mbi qasjen në dokumentet zyrtare, ka për qëllim që qytetarëve të Kosovës t'u mundësohet që të marrin pjesë në procesin vendimmarrës të institucioneve publike dhe të garantohet që institucionet publike të gëzojnë legjitimitet dhe transparencë më të madhe, të jenë më efikase dhe t'i japin më shumë llogari qytetarëve të Kosovës, gjithnjë duke barazuar dhe shtytur formën elektronike të së drejtës në qasje në dokumente zyrtare.

Ligji nr. 02/L-28 për procedurën administrative pranon dhe njeh formën elektronike të punës së organeve të administratës publike që ushtrojnë veprimtarinë administrative.

Janë miratuar edhe disa Udhëzime administrative të cilat rregullojnë aplikimin e fushës së TI-së në institucionet qeveritare siç është Udhëzimi Administrativ për përdorimin e softuerëve të licencuar Nr. 2007/02-MSHP, Udhëzimi Administrativ për Forcimin e Transparencës dhe Standardizimit të Faqeve të Internetit Nr. 07/2008 Udhëzimi Administrativ për Shfrytëzimin e postës elektronike zyrtare, Nr. 2005/03-MSHP, Udhëzimi Administrativ për përdorimin e telefonave (fiks dhe mobil) në Qeverinë e Kosovës. 04/2008.

Po ashtu janë miratuar disa politika dhe janë aplikuar disa standarde si, Politika për Harduer dhe Softuer, Politika e Shfrytëzimit të Pranueshëm të Qasjes në e-Mail dhe Internet, Politikë të Kompensimit për Trajnim të Stafit në TI, **ISO 9000** Sistemet e menaxhimit kualitativ-bazat dhe fjalori, **ISO 9001** Sistemi i menaxhimit kualitativ-kërkesat, **ISO 9004** Sistemi i menaxhimit kualitativ udhëzime për përmirësime në punë, **ISO/IEC 17799** Teknologjia informacionit kodi i praktikës për menaxhimin e sigurisë së informatave.

4.1. Amandamentimi i ligjeve dhe modifikimi i politikave dhe standardeve

Ligjet, Udhëzimet administrative dhe Politikat e miratuara tashmë kanë mangësitë e tyre dhe lind nevoja që ato të ndryshohen respektivisht të modifikohen. Gjatë periudhës në vazhdim do të amandamentohet ligji për shërbimet e shoqërisë së informacionit dhe ligjet të tjera që kanë të bëjnë me shërbimet elektronike dhe TIK-un si, ligji për qasje në dokumente zyrtare, ligji për procedurën administrative, ligji për noterinë, ligji për procedurën civile, ligji për të drejtën e autorit, etj.

Do të modifikohen udhëzimet administrative, politikat dhe rregulloret, si Udhëzimi Administrativ për e-mailin zyrtar, Udhëzimi Administrativ për përdorimin e Softuerëve të Licencuar, Udhëzimi administrativ për përdorimin e telefonave fiks dhe mobil, Politika për harduer dhe softuer, Politika për Internet dhe E-mail, etj.

4.2. Ligjet dhe politikat e reja

Përgjegjësia në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ka qenë e përcaktuar përmes rregullores së **UNMIK-ut 2001/19**. Me pavarësinë e Republikës së Kosovës dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së vendit, gjërat tani kanë ndryshuar, gjë që do të ndikojnë edhe në nxjerrjen e ligjeve të reja ku përgjegjësitë përcaktohen me ligj. Tash është në proces të finalizimit të ligjit mbi funksionet e organeve qeveritare, nga do të përcaktohen përgjegjësitë e secilit organ qeveritar. Në aspektin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nuk do të ketë ndonjë ndryshim esencial, përveç që do të shtohet përgjegjësia në fushën e qeverisjes elektronike (e-Qeverisjes). Nga përvojat e vendeve të tjera, fusha e qeverisjes elektronike është një shtyllë e rëndësishme shtetërore e fokusuar në realizimin me efikasitet të shërbimeve të administratës publike dhe faktor të tjerë me rëndësi në zhvillimin e vendit.

Gjithashtu për të ardhmen e afërt është shumë me rëndësi që të kemi një ligj të veçantë për të gjitha çështjet e qeverisjes elektronike. Vendet që kanë arritur në qeverisje elektronike, së fundmi kanë realizuar Ligjin për qeverisjen elektronike.

Në proces është ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, Ligji për kryedomenin shtetëror të Republikës së Kosovës, që pas miratimit do të përcaktojë rregullat e sigurisë të të dhënave personale dhe rregullat e organizimit dhe menaxhimit në mënyrë hierarkike të domeneve dhe nëndomeneve. Ende është në proces të draftimit Ligji për themelimin e Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit, ligj i cili do të varet nga Ligji i Qeverisë i cili po ashtu është në proces.

Do të krijojmë standarde të reja të bazuara në ISO standardet sidomos tek ISO standardi për sigurinë e informatave. Do të nxierren udhëzime të reja administrative dhe politika të reja që rregullojnë tërë procesin e menaxhimi të zbatimit të standardeve të teknologjisë së informacionit, që rregullojnë procesin e krijimit dhe ofrimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe qeverisjes elektronike, që rregullojnë përgjegjësitë dhe hierarkinë në mënyrë që të eliminohen defektet organizative të periudhës së kaluar. Detyrimisht do të përcillen zhvillimet në qeverisje elektronike dhe TIK-ut në botë, në mënyrë që standardet e arritura të aplikohen nga të gjitha institucionet e vendit.

Politikat e reja do të bazohen në krijimin e konkurrencës së lirë të vlerave të arritura, si në fushën e harduerit e po ashtu në fushën e softuerit. Do të krijohet një Partneritet Publik Privat i qëndrueshëm, i cili sjell dobi në avancimin e fushës së qeverisjes elektronike dhe TIK-ut.

Të gjitha projektet që synohen, të përshkruara në këtë strategji, do të përcillen me norma ligjore, me politika dhe me udhëzime që respektojnë realizimin e tyre.

5. INTEROPERABILITETI

5.1. Përshkrimi i interoperabilitetit

Periudha e kaluar ka krijuar barriera të cilat në periudhën pasuese duhen eliminuar. Këto probleme janë shkaktuar nga mosrespektimi i përgjegjësive të përcaktuara në rregulloren e UNMIK-ut 2001/19, nga ana e shumë institucioneve qeveritare. Realizimi i shumë projekteve të cilat nuk kanë respektuar standardet dhe politikat e miratuara, ka sjellë një situatë ku aplikohen platforma të ndryshme, si në infrastrukturë e po ashtu edhe në sistemet që janë të aplikuara. Krijimi i këtyre “oazave” që respektojnë rregulla dhe platforma të ndryshme, detyrimisht obligon angazhimin dhe bashkëpunimin institucional për realizimin e ndërveprimit të sistemeve, interoperabilitetit.

Interoperabiliteti paraqet aftësinë e sistemeve të TIK-ut dhe proceseve logjike që mbështesin shkëmbimin e të dhënave dhe i bëjnë ato të përdorshme për qëllime të ndryshme.

5.2. Interoperabiliteti në institucionet qeveritare të Kosovës

Ne do të zhvillojmë një ndërveprim përmbajtësor të sistemeve dhe shërbimeve elektronike (semantik), ndërveprim në mes të institucioneve, por edhe të ndërtimit të sistemeve të informacionit (organizativ) dhe ndërveprim në aspektin e funksionalizimit strukturor të sistemeve dhe shërbimeve elektronike (teknik).

Të gjitha sistemet aktuale që funksionojnë, uebfaqet e ndryshme të institucioneve dhe portalet në të ardhmen, duhet që të ndërveprojnë ndërmjet tyre dhe kjo është një punë shtesë e vazhdueshme e institucioneve qeveritare. Së shpejti do të jetë e domosdoshme që Sistemi i Menaxhimit të Pagesave të ndërveprojë me Sistemin e Menaxhimit të Personelit, Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit, Sistemi i Menaxhimit të Pensioneve, etj. Kur të merren parasysh ndërtimet e këtyre sistemeve, nxjerrin domosdoshmërinë që të kemi një plan veprimi për arritjen e ndërveprueshmërisë së të gjitha sistemeve që janë të aplikuara në institucionet e Kosovës. Kjo kërkon studim, angazhim të institucioneve, koordinim të të gjithë përgjegjësve dhe ekspertëve që merren me fushën e TI-së dhe qeverisjes elektronike. Dallimet e krijuara gjatë viteve edhe në aspektin e arkitekturës së aplikuar në projektet e TI-së në institucione, paraqesin sfida për të ardhmen me të cilat duhet të ballafaqohemi patjetër. Prandaj duke respektuar qëllimin tonë që të aplikojmë zgjidhet më të mira të ndërveprimit, gjatë periudhës pasuese, ne do të hartojmë Kornizën e Ndërveprimit (Interoperabilitetit) të Kosovës. Hartimi i kësaj Kornize do të ndihmojë shumë në arritjen e ndërveprimit të sistemeve, shërbimeve elektronike dhe arkitekturës së teknologjisë së informacionit.

Hartimi i Kornizave kombëtare të Interoperabilitetit është edhe një rekomandim që del nga Korniza e Interoperabilitetit pan-Evropian dhe kjo do të përgatisë Kosovën për

ndërveprimet e Sistemeve dhe shërbimeve elektronike të saj me ato të vendeve të ndryshme të BE-së.

5.3. Interoperabiliteti pan-Evropian

Interoperabiliteti Pan-Evropian është krijuar për të gjitha vendet e BE-së, në mënyrë që sistemet, shërbimet elektronike dhe arkitektura e TIK-ut të ndërveprojë në mes të gjitha shteteve të BE-së. Kjo ndihmon vendet që të kyçen më shpejt dhe me lehtë në Sistemet pan-evropiane të shkëmbimit të të dhënave, sidomos në Sistemet e sigurisë dhe të mbrojtjes së kufirit. Orientimet e tilla në fushën e Interoperabilitetit janë ndihmesë e madhe edhe për vendet që dëshirojnë të integrohen në të gjitha strukturat e BE-së. Kosova vazhdimisht do të përcjellë të gjitha rekomandimet që dalin nga Korniza Pan-Evropiane e Interoperabilitetit dhe të gjitha versionet pasuese të kësaj Kornize.

Në Kornizën Pan-Evropiane të Interoperabilitetit janë të paraqitura se si vendet e ndryshme të BE-së ndërveprojnë në aspektin organizativ, në aspektin e ndërveprimit të përmbajtjes (semantik) dhe në aspektin e ndërveprimit teknik.

Korniza Pan-Evropiane e Interoperabilitetit, V 1.0, përfshinë 17 rekomandime esenciale lidhur me interoperabilitetin në vendet e BE-së. Prej tyre 3 rekomandimet e para janë të aspektit të përgjithshëm, 3 të tjera janë rekomandime të interoperabilitetit organizativ, 3 rekomandime të interoperabilitetit semantik dhe 8 rekomandime të interoperabilitetit teknik.

6. SFIDAT

Gjatë periudhës së kaluar fusha e TI-së është ballafaquar me problematika të ndryshme. Ka patur mosrespektim të udhëzimeve administrative, politikave dhe standardeve, ka pastur mungesë komunikimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve, buxhetimi joracional dhe pa i respektuar prioritetet kanë sjellë shpenzime të panevojshme, politikat jo adekuate ndaj stafit të TI-së kanë sjellë largime të ekspertëve nga administrata publike, krijimi i disa qendrave të sistemeve të TI-së në institucione qeveritare, mosrespektimi i rregullave të sigurisë, etj.

Shumica e problemeve të së kaluarës janë prezente edhe sot e kësaj dite në institucionet qeveritare.

6.1. Sfidat e së ardhmes

Duke ditur përmbajtjen e sfidave që kemi kaluar më parë, nuk duhet të pretendojmë se ato tashmë janë tejkaluar, nga se çdo periudhë ka sfidat e veta, aq më parë që ne po trashëgojmë probleme të theksuara të së kaluarës në fushën e TIK-ut. Bazuar në të gjithë parametrat matës të rreziqeve, mund të konstatojmë që edhe në periudhën pasuese do të kemi problematika të theksuara.

Sensibilizimi i autoriteteve vendimmarrëse ende nuk është në nivelin kënaqshëm dhe kjo mund të paraqes rrezik për të gjitha synimet që janë paraparë në këtë strategji.

Sfidë tjetër mund të jenë tendencat e caktuara që dalin gjatë zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve të ndryshme elektronike në mbarë botën.

Konkurrenca e lirë në botën e përgjithshme të qeverisjes elektronike dhe teknologjive të ndryshme mbështetëse të saj, paraqet rreziqe të konsiderueshme dhe pasiguri të orientimeve të planifikuara.

Gjithashtu sfida mund të paraqiten edhe nga ndryshimet politike. Kjo është tepër e rëndësishme për t'u marrë në konsideratë.

Një sfidë tjetër është vazhdimi i mentaliteteve të vjetra në lidhje me aplikimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit në institucionet qeveritare.

Reflektimi ndaj burimeve njerëzore paraqet një sfidë për të ardhmen, dhe nëse orientimi ndaj kësaj kategorie të rëndësishme në realizimin e planifikimeve të parapara në këtë strategji, bëhet në mënyrën jo të duhur, atëherë kjo paraqet rrezikun potencial të dështimit.

Kalimi nga platforma në platformë dhe mos koordinimi rajonal dhe evropian paraqesin rreziqe të tjera.

Mungesat buxhetore gjatë realizimit të planifikimeve është një rrezik tjetër që mund të paraqitet. Po ashtu mund të dështojnë edhe projekte të ndryshme të cilat mund të mbajnë peng projektet tjera në proces. Planifikimi jo i duhur paraqet një sfidë esenciale, dhe duhet që herë pas here të rishikohen parametrat matës.

Vonesat në procesin e realizimit të projekteve konkrete e po ashtu në atë të kompletimit të paketës legjislativë për qeverisje elektronike dhe TIK-ut sipas planifikimit, paraqesin një mundësi tjetër të dështimit.

Ndaj të gjitha rreziqeve të tilla, institucionet tona duhet të veprojnë në mënyrën e duhur dhe në kohën e duhur, sepse vetëm kështu mund të eliminohen apo të parandalohen ato. Ky do të ishte sukses i madh në realizimin e Strategjisë për qeverisje elektronike.

Shkurtesa

Domethënia

ZKM	Zyra e Kryeministrit
ADSL	Asymmetric Digital Subscriber Line
AER	American Economic Review
AFIS	Automated Fingerprint Identification System
AKK	<u>Agjencia Kadastrale e Kosovës</u>
AKP	<u>Agjencioni Kosovar Për Prona</u>
AKPM	Agjensioni i Kosovës për Produkte Medicinale
AOS	Arkitekturë e Orientuar në Shërbime
ASHAK	Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
ASPAUK	Agricultural Statistics and Policy Advisory Unit Kosovo
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BDMS	Budget Development and Management System
BE	Bashkimi Europian
CD	Compact Disc
CISCO	Computer Information System Company
DFID	Department For International Development
DMS	Document Management System
DTI	Departamenti i Teknologjisë Informativë
e-	electronic
EMIS	Emergency Management Information System
G2B	Government-to-Business
G2C	Government-to-Citizen
GIS	Geographic Information System
GPRS	General Packet Radio Service
GSM	Global System for Mobile communications
GTZ	Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit
HIS	Health Information System
HP	Hewlett Packard
IBM	International Business Machines
ID	Identity Document
IDS	Intrusion Detection System
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IOM	<u>International Organization for Migration</u>
IPK	Inspektoriati Policor i Kosovës
IPRR	Immovable Property Right Register
IPS	Intrusion Prevention Systems
IRRK	Infrastruktura e Rrjetit Komunikues
ISO	International Organization for Standardization
IEC	International Electrotechnical Commission
ISP	Internet Service Provider
KFOS	Kosova Foundation for Open Society
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KK	Kuvendi Komunal
KPIS	Kosovo Police Information System
LAN	Local Area Network
m-	mobile
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MASHT	<u>Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë</u>
Mbps	Megabit per second
MBPZHR	<u>Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural</u>
MD	<u>Ministria e Drejtësisë</u>
MEF	<u>Ministria e Ekonomisë dhe Financave</u>
MEM	<u>Ministria e Energjisë dhe Minierave</u>
MK	Ministria e Kulturës
MKRS	<u>Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit</u>
MMPH	<u>Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor</u>
MPB	<u>Ministria e Punëve të Brendshme</u>
MPMS	<u>Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale</u>
MS	Microsoft System
MSH	<u>Ministria e Shëndetësisë</u>
MSHP	<u>Ministria e Shërbimeve Publike</u>
MTI	<u>Ministria e Tregtisë dhe Industrisë</u>
MTPPT	<u>Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit</u>
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PC	Personal Computer
PIP	Programi për Investime Publike
PKI	Public Key Infrastructure
PTK	Posta dhe Telekomuni i Kosovës
SDH	Synchronous Digital Hierarchy
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
SIDA	Security Identification Display Area
SIGTAS	Standard Integrated Government Tax Administration System
SIM	Subscriber Identity Module
SIMP	Sistemi I Menagjimit të Pagave
SOAP	Simple Object Access Protocol
SQL	Structured Query Language
TI	Teknologjia e informimit
TIK	Teknologjia e informimit dhe komunikimit
TIMS	Total Information Management System
UDDI	Universal Description, Discovery and Integration
UNCITRAL	United Nations Commission on International Trade Law
UNDP	United Nations Development Programme
UNMIK	United Nations Mission In Kosovo
UP	Universiteti i Prishtinës
USAID	United States Agency for International Development
USB	Universal Serial Bus
VoIP	Voice over Internet Protocol
WAN	<u>Wide Area Network</u>
WDDX	Web Distributed Data eXchange
WiFi	Wireless Fidelity
WiMAX	Worldwide Interoperability for Microwave Access
WSDL	Web Services Description Language
XDSL	DigitalSubscriber Lines
XML	Extensible Markup Language